



# ГОДИШЕН ИЗВЕШТАЈ

за состојбите во областа на човековите права  
во Република Македонија во **2015** година

Reporti vjetor për gjendjen në fushën e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë për vitin 2015  
Annual report on the situation in the area of human rights in the Republic of Macedonia for 2015

Raporti vjetor për gjendjen në fushën e të drejtave të njeriut  
në Republikën Maqedonisë për vitin 2015

Raporti vjetor për gjendjen në fushën e të drejtave të njeriut  
në Republikën Maqedonisë për vitin 2015

**Botues:**

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë  
përfaqësuar nga Kryetari Prof. Dr. Gordan Kalajxhiev

**Redaktor:**

Uranija Pirovska



Naum Naumovski Borçe 83  
1000, Shkup  
Tel: +389 (0)2 3119 073  
Faks: +389 (0)2 3290 469  
Web: [www.mhc.org.mk](http://www.mhc.org.mk)  
E-mail: [helkom@mhc.org.mk](mailto:helkom@mhc.org.mk)

# PËRMBAJTJA

PËRGJIMI JOLEGAL DHE PROKURORIA SPECIALE.....	1
TË DREJTAT QYTETARE DHE POLITIKE.....	4
GJYQËSORI.....	10
KUSHTETUTA DHE LIGJVËNIA.....	16
INSTITUCIONE TË MBYLLURA DHE VEPRIMI POLICOR.....	19
DISKRIMINIMI.....	28
GJUHA E URREJTJES DHE VEPRA NGA URREJTJA.....	31
TË DREJTAT EKONOMIKE DHE SOCIALE.....	34
DHUNË NË BAZË TË GJINISË.....	37
KRIZA E REFUGJATËVE.....	40

## I PËRGJIMI JOLEGAL DHE PROKURORIA SPECIALE

Në fillim të vitit 2015 opozita filloi me shpalljen e bisedave midis përfaqësuesve të lartë të Qeverisë, duke përfshirë edhe kryeministrin Nikolla Gruevski dhe ka dhënë informacione se nga pushteti janë përgjuar mbi 20 000 qytetarë, duke përfshirë edhe gazetarë, aktivistë të të drejtave të njeriut dhe përfaqësues të organizatave qytetare. Akti i tillë i përgjimit masovik përbën shkelje të të drejtave të njeriut në shkallën më të lartë dhe keqpërdorim absolut të mundësisë për ndjekje të komunikimeve, duke u rrezikuar kështu sundimi i të drejtës në shtet.

Prej bisedave të shpallura në media u vërtetuan edhe konstatimet të cilat Komiteti i Helsinkit vite me radhë i ka dhënë mbi partizimin e gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë, për mosrespektimin e parimit të sundimit të të drejtës dhe për mosekzistimin e ndarjes së pushtetit. Një pjesë e bisedave të shpallura ishin edhe për gjyqësorin dhe mënyrën se si pushteti ekzekutiv ndikon mbi përzgjedhjen e gjykatësve dhe prokurorëve publikë, por edhe si dakordon vendime për raste të caktuara gjyqësore. Mandej, bisedat e shpallura japin indikacione për lidhjen e pushtetit ekzekutiv me prokurorin publik të Republikës së Maqedonisë. Bisedat e tilla nuk janë kontestuese vetëm në aspektin e gjendjes së gjyqësorit, por edhe në aspektin e të drejtave themelore të qytetarëve, sidomos të drejtës së privatësisë, nëse përcaktohen gjetjet se në mënyrë joligjore janë ndjekur më tepër se 20 000 qytetarë të Republikës së Maqedonisë.

Keqpërdorimi i autorizimeve nga DSK-ja dhe përdorimi i sistemit për përgjim për qëllimet e partisë në pushtet është konstatuar edhe në raportin e grupit ekspert të Komisionit Evropian, i cili shënon mungesa serioze në pesë fusha: ndjekje të komunikimeve, mbikëqyrje të jashtme të trupave të pavarur, gjyqësor, zgjedhje dhe media. Në pjesën e gjyqësorit konstatohet se ekziston qasje selektive dhe ndikim politik në të gjitha aspektet – nga momenti i zgjedhjes së gjykatësve dhe prokurorëve publikë, procedurat gjyqësore, vlerësimi i gjykatësve, shkarkimi i gjykatësve, funksionimi i Këshillit Gjyqësor, transparenca e zgjedhjes dhe shkarkimit të gjykatësve, funksionimi i sistemit për shpërndarje të lëndëve. Në pjesën e komunikimeve u konstatua mosrespektim i etikës profesionale, parimeve themelore të menaxhimit të rrezikshëm dhe mungesës së njohjes së ndjeshmërisë së detyrave zbuluese në suazat e DSK-së.

Gjithashtu, lëndë e shqetësimit është dhe mungesa e dukshme e shërbimit të trajnuar për të drejtat themelore dhe rregullat për mbrojtjen e të dhënave, por edhe mosinformimi i publikut për vijimin e procedurave. Prokuroria Publike, në përputhje me nenin 8 të Ligjit për Prokurorinë Publike, është e obliguar ta informojë publikun për raste të caktuara për të cilat vepron, sidomos nëse janë të natyrës së tillë që shkaktojnë interes më të gjerë në publik ose janë me rëndësi për realizimin e funksionit të prokurorisë publike që të mbrohen nga veprimtari kriminale apo veprimtari të tjera të jashtëligjshme. Fakti se prokuroria publike dhe pas

gjashtë muajsh nuk arriti të ngrejë hetim për përmbajtjen e bisedave të shpallura, e vërteton mosefikasitetin e prokurorisë publike në mbrojtjen e interesit publik dhe pamundësinë që dëshmojë pavarësi përkundrejt ndikimit nga pushteti ekzekutiv. Prokuroria publike nuk e ka shqyrtuar mundësinë se xhirimet janë marrë nëpërmjet keqpërdorimit të autorizimit të shërbimeve shtetërore të sigurimit dhe nëpërmjet keqpërdorimit të sistemit të tërësishëm të sigurimit në shtet. Këtë mundësi nuk e kanë shqyrtuar as mekanizmat për kontroll mbi punën e shërbimeve shtetërore të sigurimit. Në rastin “RADIO TWIST A.S. v. SLOVAKIA”, që mbahej para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, organet kompetente sllovaqe, gjithashtu, nuk e kanë kontrolluar atë mundësi. Gjykata tha se kjo është “mjaft për t’u habitur, duke pasur parasysh faktin se xhirimi ka të bëjë me bisedë telefonike midis dy funksionarëve të lartë dhe se dyshimi se xhirimi është marrë nëpërmjet keqpërdorimit të autorizimit nuk duhet të hidhet paraprakisht poshtë.” Me fjalë të tjera, shteti mund të hetojë në cilin drejtim që dëshiron, por nuk duhet ta pranojë paraprakisht dhe pa rezerva qëndrimin e shërbimeve të sigurimit se vepron vetëm në përputhje me autorizimet e tyre dhe se nuk i kanë tejkaluar në rastin kur ekzistojnë indikacione të dukshme për këtë gjë.

Duke i marrë parasysh indikacionet e tilla serioze mbi lidhjen dhe përzierjen e pushtetit ekzekutiv në prokurorinë publike lindi nevoja për formim të prokurorisë speciale publike për ndjekjen e veprave penale që lidhen dhe dalin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve. Më 15 shtator 2015, në përputhje me Marrëveshjen e Përzahinos, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, dhe njëzëri e miratoi Ligjin për Prokurorinë Publike për Ndjekje të Veprave Penale që lidhen dhe dalin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve. Me këtë ligj edhe zyrtarisht u parashikua ekzistimi i një prokurori publik special i cili një periudhë të gjatë ishte përfolur në publik. Në përputhje me ligjin, përveç prokurorit publik, i cili ka për detyrë të hetojë dhe ndjekë vepra penale që lidhen dhe dalin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve, është parashikuar edhe ekzistimi i prokurorisë të cilën e udhëheq prokurori publik, që përfshin edhe prokurorë publikë në këtë prokurori, hetues, ekspertë, shërbim administrativ dhe profesional.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për këtë funksion e propozoi Katica Janevën, prokurore publike në Prokurorinë Themelore Publike, Gjevgjeli. Propozimi është miratuar njëzëri nga Këshilli i Prokurorëve Publikë dhe prokurorja publike speciale ka marrë detyrën më 16 shtator, pa dhënies së betimit zyrtar.

Edhe pse zgjedhja e prokurores publike speciale ishte me procedurë urgjente, megjithatë prokuroria filloi me punë në muajin dhjetor 2015, më tepër për shkak të obstrukcioneve nga Këshilli i Prokurorëve Publikë në lidhje me ekipin e kërkuar nga prokurorja. Domethënë, Këshilli i Prokurorëve Publikë më tepër se një muaj e gjysmë ishte kundër kërkesës së prokurores që ekipi i saj të ketë 14 prokurorë, kështu që së pari zgjodhën shtatë, që mandej të zgjedhin edhe pesë prokurorë publikë. Frenimi i punës së Prokurorisë Speciale Publike vijoi pas frenimit të negociatave për plotësim të Marrëveshjes së Përzahinos, që jep dyshim të bazuar për ndikim politik mbi vendimet e Këshillit Gjyqësor. Mandej është tejkaluar edhe afati ligjor prej 35 ditësh për sigurim të mjeteve financiare për punën e Prokurorisë Speciale, që e ngadalësoi edhe më tepër punën e saj.

Gjatë muajit nëntor, Prokuroria Speciale Publike ka dorëzuar kërkesë për dorëzim të lëndëve të formuara lidhur me përgjimin të Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit dhe Korrupsionit të Organizuar dhe të prokuroritë themelore publike në Shkup, Manastir dhe Kumanovë. Lëndët e kërkuara janë dorëzuar nga të gjitha prokuroritë, përveç Prokurorisë Themelore Publike Kumanovë, për të cilën ende nuk ka informacion të vërtetuar kur e ka marrë kërkesën dhe a vepron jashtë afatit ligjor prej 8 ditësh për dhënien e lëndës.

Është pozitive rrethana se janë zgjedhur 12 prokurorë si pjesë e ekipit të Prokurorisë Speciale Publike, por pa ekip për hetues dhe bashkëpunëtorë profesionalë, pa shërbim administrativ, të cilët janë parashikuar në nenin

2 paragrafi 3 i Ligjit për Prokurorinë Publike për ndjekje të veprave penale që lidhen dhe dalin nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve. Kjo kontribuoi mbi mungesë e efikasiteti të deriatëhershëm të Prokurorisë Speciale Publike.

Më 14 dhjetor PSP-ja mori vendim për themelim të kompetencës reale mbi 34 lëndë, duke përfshirë edhe lëndën e njohur në publik si “Puçi” ku një prej të akuzuarve është edhe lideri i opozitës, Zoran Zaev. Ndërkohë, PSP-ja ka dhënë mendim pozitiv për ndërprerjen dhe zëvendësimin e masës paraburgim ndaj të akuzuarve Zoran Verushevski dhe Gjorgji Llazarevski të dorëzuar nga mbrojtësit e tyre. Në bazë të mendimit të tillë Këshilli Penal i Njësisë për Krim dhe Korrupsion të Organizuar në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup, vendosi ta ndërpresë masën paraburgim dhe është përcaktuar ndalim për lëshim të vendbanimit dhe marrje e përkohshme e dokumentit të udhëtimit si masë kujdesi.

## II. TË DREJTAT QYTETARE DHE POLITIKE

### 1. HYRJA

Në fillim të vitit 2015, duke pasur parasysh intensitetin e krizës politike, u organizuar shumë tubime publike, me qëllim që të shprehet revoltë ndaj politikave të strukturës aktuale qeveritare. Domethënë, të nxitur nga e drejta e vet e garantuar me Kushtetutë për tubim publik, qytetarët e Maqedonisë për arsye të ndryshme, theksuan thyerjen sistematike të të drejtave dhe lirive të njeriut në shtet pothuajse në të gjithë segmentet e shoqërisë.

Liritë e mediave, autonomia universitare, të drejtat e punëtorëve, brutaliteti policor, të drejtat e përfaqësuesve të bashkësisë LGBTI, ishin vetëm një pjesë e temave rreth të cilave u konsolidua revolta qytetare, përkatësisht tensioni nëpërmjet të cilit qytetarët u përfshinë në procesin e marrjes së vendimeve politike.

Puna e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM, përfshin edhe mbikëqyrjen e tubimeve publike, me qëllim që të përcaktohet sjellja policore dhe shkeljet e mundshme të të drejtës së shoqërimin dhe tubimit paqësor të qytetarëve. Në atë drejtim, ekipi i Komiteti i ka ndjekur të gjitha tubimet publike më të rëndësishme, me qëllim që të dokumentojë dhe reagojë ndaj shkeljeve të paraqitura apo të vëzhguara të autorizimeve policore dhe shkelje të tjera të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut është konstatuar se veprimi i policisë gjatë një pjese të tubimeve publike u karakterizua me përdorim të zbatimit të jashtëzakonshëm të forcës dhe masave për detyrim. Konstatimi i tillë është nxjerrë edhe gjatë protestave të cilat u mbajtën më 5 maj si dhe protestat të cilat vijuan pas kësaj date, kur nëpunësit policorë e kufizuan të drejtën e lëvizjes së lirë, por njëkohësisht edhe të drejtën e tubimit publik.

### 2. PROTESTA 5 - 17 MAJ

Komiteti i Helsinkit nëpërmjet përfaqësuesve të vet ishte i pranishëm në protestën qytetare para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ku qytetarët e shprehën përsëri revoltën e tyre për mosmarrjen e përgjegjësisë për vrasjen e Martin Neçkovskit. Deri në orën 20:30, protesta ka qenë pa incidente dhe ballafaqime më të mëdha midis qytetarëve dhe policisë. Ballafaqimet e para më serioze me policinë filluan rreth orës 22 kur policia filloi t'i shtyjë të gjithë qytetarët të cilët ishin para Qeverisë.



Komiteti i Helsinkit vuri re se policia gjatë shtyrjes së qytetarëve përdori forcë të madhe dhe të jashtëzakonshme. Nëpunësit policorë nuk e kufizuan përdorimin e forcës vetëm ndaj qytetarëve të cilët ishin agresivë ndaj tyre, por në mënyrë joselektive i godisnin dhe shkelnin të gjithë qytetarët, pjesa më e madhe e të cilëve rinin ulur në tokë me duart lart. Pastaj, policia nisi arrestimin e pjesëmarrësve në protestë. Gjatë arrestimit, policia përdori përsëri forcë të jashtëzakonshme të madhe dhe joselektive. Arrestimi vazhdonte edhe kur qytetarët nuk merrnin më pjesë në protestë dhe shkonin drejt shtëpive të tyre. Këtë e vërteton edhe fakti se në orën 23.30 nëpunësit policorë hynë me dhunë në shumë objekte, midis të cilave edhe në Bibliotekën e Qytetit “Vilhezërit Milladinovci” dhe përdorën përsëri forcë të jashtëzakonshme të madhe ndaj të gjithë të rinjve që ishin në bibliotekë me pretekstin se një pjesë e tyre ishin pjesëmarrës në protestë.

Sipas informacioneve të cilat i disponon Komiteti, në këto incidente ishin arrestua mbi dyzet e dy persona, pjesa më e madhe e të cilëve ishin mbajtur 24 orë në shumicën e stacioneve policore në Shkup. Përfaqësuesit e Komitetit kanë vënë re se pjesa më e madhe e të arrestuarve nuk ishin pjesë e grupit i cili u ballafaqua policinë, kurse një pjesë e tyre nuk kishin marrë fare pjesë në protestë. 15 personave u është caktuar paraburgim, 1 personi i është caktuar paraburgim në shtëpi, kurse 2 persona ishin në ikje. Nga personat e arrestuar, 5 ishin studentë, prej të cilëve 2 persona ishin përfaqësues të Plenumit Studentor.

Personat janë të dyshuar për pjesëmarrje në turmë që pengon personin zyrtar në zbatimin e veprimeve zyrtare (neni 384 paragrafi 1 i Kodit Penal). Dënimi për këtë veprë penale është 3 muaj deri në 3 vjet, sepse konsiderohet si veprë më e lehtë penale, për të cilën në parim nuk duhet të përcaktohet masa paraburgim, por duhet të shfrytëzohen masat e tjera alternative që janë në dispozicion për sigurim të pranishmërisë. Komiteti konsideron se vendimet e tilla ndikojnë në kufizimin e të drejtës së protestës, sidomos për shkak të faktit se si arsye për paraburgim është vendosur se të paraburgosurit mund ta përsërisin veprën penale duke pasur parasysh se janë paralajmëruar protesta të reja. Gjithashtu, vendimet për paraburgim dhe për zbatim të procedurave penale kundër studentëve mund të konsiderohen si paralajmërim për qytetarët e tjerë të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në protestat të cilat mbahen në këtë periudhë. Për krahasim, Komiteti kishte monitorim të protestave të dhunshme kundër Komunes Qendër, të cilat u mbajtën në vitin 2014, për të cilat kundër pjesëmarrësve nuk është ngritur procedurë gjyqësore, prandaj mund të konstatohet se është e evidente se ekziston përzgjedhje.

Prej demonstruesve të cilët janë ndjekur penalisht, përveç dy demonstruesve, të gjithë të tjerët e pranuan fajin, prandaj pjesës më të madhe u është përcaktuar dënim me kusht burgim prej 3 muajsh i cili nuk do të zbatohet nëse në afat prej 1 viti nuk e përsëritin veprën. Te Komiteti i Helsinkit me kërkesa për ndihmë juridike u paraqitën vetëm një pjesë e personave të cilët ishin arrestuar dhe privuar nga lira 24 orë pas protestës, por edhe personat mbi të cilët ishte ushtruar dhunë e jashtë mase, kurse të cilët kanë marrë ose nuk kanë marrë pjesë në protestë.

Pjesa më e madhe e personave mbi të cilët është zbatuar forcë e jashtë mase nga policia janë gjendur në rrugicën e vogël afër Bulevardit “Kliment Ohridski”, ku grupi prej 30 policësh i ka ndjekur qytetarët të cilët kanë filluar të fshihen në hyrjet e ndërtesave. Mbi ata persona të cilët nuk arritën t'i ikin policisë, është përdorur forcë e jashtë mase, edhe pse sipas deklaratave të qytetarëve ata nuk kanë dhënë rezistencë dhe as nuk e kanë ditur pse i ndjek policia.

Rasti 1 - 2 persona (mashkull dhe femër) janë sulmuar nga një grup prej 6 policësh dhe kanë marrë lëndime fizike nëpër gjithë trupin, kurse një person ka pësuar lëndime fizike në pjesën e kokës. Mandej janë dërguar në stacionin policor dhe janë mbajtur 24 orë.

Rasti 2 – 2 persona (mashkull dhe femër) janë ndjekur nga një grup prej 4 personash, prandaj janë fshehur në podrumin e një prej hyrjeve në ndërtesat përreth. Pasi janë gjetur nga policia duke i tërhequr janë nxjerrë jashtë hyrjes, i kanë shtrirë në trotuar dhe kanë sulmuar fizikisht. Pastaj janë lëshuar.

Rasti 3 – 1 person (mashkull), që nuk ka qenë pjesëmarrës në protestë është takuar nga një grup nëpunësish policorë në Bulevardin “Kliment Ohridski” është shtrirë në trotuar dhe është rrahur nga policia, më pas është çuar në stacion policor dhe është mbajtur 24 orë.

Rasti 4 – 2 (meshkuj) në bulevardin “Partizanski Odredi” para Katedrales, duke qenë me duar të ngritura si shenjë se protestojnë në paqe, janë sulmuar fizikisht nga një grup policësh, arrestuar dhe mbajtur në stacion policor 24 orë.

Rasti 5 – 1 person, i cili ka qenë në protestë me cilësi të gazetarit, është takuar nga dy nëpunës policorë dhe është sulmuar fizikisht duke marrë kështu lëndime fizike në pjesën e dorës së djathtë dhe në kokë.

Numri më i madh i personave të cilët erdhën në Komitetin i Helsinkit ta paraqitin dhunën policore nuk duan të ngrenë procedura kundër tejkalimit të policisë dhe përdorimit të forcës fizike të jashtë mase, për shkak të mosbesimit në institucionet. Ata konsiderojnë se të drejtat e tyre nuk do të mbrohen dhe se procedurat eventuale të cilat do të ngriheshin do t'i dëmtonin ata dhe familjet e tyre. Deklaratat e tilla e vërtetojnë konstatimin të cilin Komiteti i Helsinkit e jep në raportet e veta në lidhje me mosbesimin e qytetarëve ndaj institucioneve, sidomos mbi gjyqësorin, për shkak të partizimit të tyre dhe pamundësisë që t'i kundërvihen ndikimit nga pushteti ekzekutiv.

Pas protestës së mbajtur më 05.05.2015, protestat vazhduan deri më 16.05.2015, çdo ditë në orën 18, të organizuara nga lëvizja qytetare “Protestoj”. Në periudhën nga 06.05 deri në 16.05.2015 nuk ka pasur përplasje midis policisë dhe demonstruesve, Por, praktika e MPB-së që të mos lejohet mbajtja e tubimit publik para Qeverisë së RM-së vazhdoi deri në fund të mbajtjes së tyre, deri më 16.05.2015. Prandaj, grupi çdo ditë mblidhej në afërsi të Qeverisë dhe lëvizte drejt institucioneve të ndryshme shtetërore, dhe mandej është drejtuar para ndërtesës së Kuvendit të RM-së.

Për arsye se kufizimi i mëtejshëm i të drejtës për tubim paqësor dhe protestë publike është i pabazuar, Komiteti konsideron se Policia e ka shkelur të drejtën kushtetuese të qytetarëve për tubim paqësor dhe protestë publike (neni 21 i Kushtetutës së RM-së), prandaj ekzistojnë baza të dyshimit se nëpunësit udhëheqës policorë e kanë përmbushur ekzistimin ligjor të veprës penale Parandalim apo pengim i tubimit publik (neni 155, p. 2 KP të RM-së).

Nga të gjitha shkeljet e dhëna nga policia, prokuroria publike deri më tani nuk ka ngritur asnjë procedurë me obligim zyrtar kundër nëpunësve policorë. Sipas njohurive të Komitetit të Helsinkit, për ngjarjen në bibliotekën “Vëllezërit Milladinovci” është ngritur fletëparaqitje penale në prokurori nga Partia Liberal-Demokratike, kurse personat mbi të cilët është ushtruar forcë e jashtëzakonshme nga policia vetëm një person ka dorëzuar fletëparaqitje penale për Keqtrajtim në shërbim. Edhe përkrah seriozitetit të veprimeve, prokuroria publike ende nuk e informuar publikun për vijimin e hetimit dhe a do të iniciohet procedurë penale kundër nëpunësve policorë të dyshuar.

### 3. PLENUMI STUDENTOR DHE I PROFESORËVE

Lufta akademike e cila çoi në mobilizimin e studentëve, kurse mandej edhe të profesorëve, si edhe te formimi i plenumëve dhe veprimi nëpërmjet tyre, vazhdoi edhe në vitin 2015. Domethënë, duke u udhëhequr

edhe mandej nga pakënaqësia prej papërgjegjshmërisë së pushteteve, kurse të nxitur sidomos nga ngjarjet e janari pasi Kuvendi i Republikës së Maqedonisë i miratoi, kurse presidenti Gjorgje Ivanov i nënshkroi ndryshimet e Ligjit për Arsimin e Lartë, të dy plenumet ishin në koordinim dhe mbajtën dy tubime protestuese para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Pas përfundimit të ngjarjeve, një numër i caktuar mediash vazhduan me praktikën e vendosur për etiketim të pjesëmarrësve në protesta pa dallim të rolit të tyre si organizatorë apo mbështetës së kauzës. Duke e pasur parasysh këtë praktikë të mediave, e cila u bë karakteristikë gjatë informimit për çdo lloj të shprehjes së pakënaqësisë qytetare, Komiteti ka shprehur shqetësim për informimin joetik për protestat dhe tubimet publike sepse qëllimi i tyre ishte dezinformimi i publikut përkundrejt obligimit kushtetues – transmetim dhe marrje të paanshme dhe objektive të informacioneve.

Duke pasur parasysh qëndrimin ignorues të pushteteve ndaj kërkesave të studentëve dhe profesorëve, pas një sërë konsultimesh dhe propozimeve konstruktive, u nxor përfundimi se mandej nuk nevojitet asnjë lloj negociatash apo kontakti me pushtetin ekzekutiv si propozues të ndryshimit të Ligjit për Arsimin e Lartë, si dhe me cilindo institucion të prekur. Domethënë, studentët morën vendim, i cili është mbështetur edhe nga profesorët, për shpalljen e “Zonës autonome” në suazat e Fakultetit Filozofik/Fakultetit Filologji “Bllazhe Koneski” të UKEM. Ky koncept i të a.q. “okupim” filloi të zhvillohet si praktikë e mirë në dhënien e rezistencës dhe filloi të bëhet karakteristikë për protestat akademike në rajon dhe më gjerë, por aktualizohej si e tillë me lëvizjen globale “Occupy”. Zona autonome, e cila ishte krijuar nga studentët, si hapësirë dhe kohë me të cilën u bë ndalim i praktikave antidemokratike dominuese, përfaqësonte njëkohësisht edhe bashkësi politike, e mbajtur sipas parimeve të barazisë, përfshirjes dhe solidaritetit. Përmbajtja e Zonës autonome e dëshmonte qartë këtë gjë, duke pasur parasysh temat dhe çështjet që ishin hapur me kurikulën alternative, interaksionin, diskutimin, si dhe hapjen ndaj llojeve të shumta të sfidave kreative.

Edhe përkrah atmosferës së tensionit gjatë ditëve të para, vlerësimi i përgjithshëm për sigurinë e Zonës autonome ishte solid. Anëtarët e ekipit të Komitetit kishin mbikëqyrësit e vet gjatë gjithë periudhës së ekzistimit të Zonës autonome, kurse është mbajtur edhe trajnim me qëllim që të mbahet më mirë siguria dhe rendi i “fakulteteve të okupuar”. Në Shkup në suazat e Universitetit “Shën Kirili dhe Metodij”, ishin “okupuar” Fakulteti Filozofik/Filologjik, Fakulteti i Arkitekturës, si dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike. Studentët e Manastirit të Plenumit Studentor, gjithashtu e zgjeruan këtë praktikë alternative të dhënies së rezistencës edhe në Fakultetin Teknik në Manastir. Edhe përkrah faktit se kërcënimi mbi sigurinë në Manastir ishte më i madh, sepse një pjesë e grupeve neonaziste hynë në Fakultetin Teknik, si dhe për shkak të problemeve teknike dhe ndërprerjes së energjisë elektrike, Zona autonome e Manastirit kontribuoi në angazhimin e përgjithshëm studentor dhe në vetorganizimin në luftën për një arsim më të mirë.

Të motivuar nga mbrojtja e autonomisë së Universitetit, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, studentët dhe profesorët në aktivitetet e veta, të cilat kulmuan me Zonën autonome, folën mbi nevojën e deliberalizimit në shoqëri, nga praktikimi i demokracisë së drejtpërdrejtë si dhe mbi reagimin nëpërmjet parimeve të kulturës dinamike. Me dinamikën e tillë, studentët dhe profesorët, nëpërmjet veprimtarisë së tyre në plenum, nxitën edhe organizim të mëtejshëm qytetar dhe dhënie rezistence ndaj politikave të këqija publike të strukturës pushtetare aktuale. Domethënë, nëpërmjet Zonës autonome e cila njëkohësisht e shënonte dhe trysninë kreative ndaj pushteteve ekzekutive, të cilat paraprakisht kanë refuzuar çfarëdo lloj bashkëpunimi dhe e kanë mbuluar dukjen e këtij grupi të rëndësishëm qytetar, studentët dhe profesorët kanë ndikuar në tërheqjen e përkohshme të propozim-ndryshimeve të Ligjit për Arsimin e Lartë. Me këtë akt, studentët dhe profesorët hynë në negociata me përfaqësuesit e pushtetit ekzekutiv, të ndërmjetësuar

nga rektori, Velimir Stojkovski, të cilat rezultuan me grupe pune për përgatitjen e një ligji krejtësisht të ri për arsimin e lart.

Edhe përkrah reagimeve të përkohshme të Plenumit Studentor dhe Plenumit të Profesorëve, lidhur me procesin e përgatitjes së ligjit të ri për arsimin e lartë, si dhe për tema të tjera nga fusha e punës akademike dhe funksionimit akademik, në periudhën e mëtejshme të dy plenumet e ndalën veprimtarinë.

#### 4. PLENUMI I GJIMNAZISTËVE DHE I ARSIMTARËVE

Në muajin mars, filluan paralajmërimet për protesta të plenumeve të gjimnazistëve, të cilat u formuan dhe filluan të veprojnë kundër të a.q. reformave në arsimin e mesëm. Kështu, në shumicën e qyteteve, gjimnazistët u organizuan me kërkesë që të dëgjohen argumentet e tyre për ndërprerje të testimit ekstrën dhe kthim të sistemit të mëparshëm të zbatimit të maturës shtetërore nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Megjithatë, që në kohën e paralajmërimeve për protesta, te Komiteti u drejtuan gjimnazistë nga shumica e qyteteve të cilët dëshmuar se janë të pasqyruar ndaj trysnive dhe kërcënimeve për ndërprerje të aktiviteteve.

Përveç këtij lloji trysnish, të cilat për fat të keq ishin ndërmjetësuar nga zyrtarët në shkollat e mesme në Shkup, si dhe nëpër të gjithë Maqedoninë, gjimnazistët nuk ishin kursyer as nga fushata negative agresive,<sup>1</sup> e cila ishte udhëhequr nga ushtrues që janë të panjohur deri më tani të cilët kanë shpërndarë përmbajtje shqetësuese nëpërmjet posterëve dhe fletëpalosjeve në qytetet ku gjimnazistët demonstuan rezistencë të madhe. Trysnitë më të mëdha ishin vënë re në Shkup, Manastir, Veles dhe Resnjë. Komiteti ka shprehur shqetësim për materialet e shpërndara sepse fletëpalosjet dhe posterët përmbanin gjetje të cilat kishin për qëllim të identifikojnë organizatorë, duke i treguar si të rinj të korruptuar dhe me parti me qëllim që ta delegitimojnë të gjithë lëvizjen dhe ta dezinformojnë publikun.

Për fat të keq, kjo situatë me trysni u manifestua edhe në formën e kërcënimeve të drejtpërdrejta, mbylljen e të rinjve në shkolla, përpjekje për blerje dhe propozime të pakëndshme për një pjesë të prindërve nga partia në pushtet.<sup>2</sup>

Me rastin e këtyre trysnive, Komiteti i rikujtoi publikut se Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e garanton lirinë e shoqërimit, shprehjes si edhe lirinë e mbajtjes së tubimeve publike. Gjithashtu Kushtetuta garanton mbrojtje kur janë shkelur dinjiteti dhe reputacioni i qytetarit. Duke pasur parasysh faktin se në rastin konkret ishin shkelur të drejtat e personave të cilët nuk kanë mbushur 18 vjet, janë të zbatueshme edhe dispozitat e Konventës së Mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Domethënë, në nenin 14 dhe nenin 15 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve thuhet se – fëmijët kanë të drejtë të lirisë së mendimit, lirisë së shoqërimit dhe lirisë së tubimit në paqe. Prandaj, si domosdoshmëri u theksua nevoja që institucionet duhet të dëshmojnë se i mbrojnë seriozisht këto të drejta dhe duhet të zbatojnë hetim për kryerësit me qëllim që ata të identifikohen, kështu që personave të cilëve u janë shkelur të drejtat do t'u mundësohet të marrin mbrojtjen përkatëse. Në fund, duke pasur parasysh të gjithë situatën në të cilën janë rrezikuar të drejtat e gjimnazistëve, Komiteti vlerësoi se gjatë veprimeve të tilla është përmbushur ekzistimi i veprave penale për rrezikim të sigurisë të më tepër personave, ndalim dhe pengim të tubimeve publike dhe dhunë.

Pas protestave dymujore, bojkotit të mësimit, revolta e gjimnazistëve rezultoi me vendosjen e kampit përballë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nga Plenumi i Gjimnazistëve. Por me përforsimin e strategjive të gjimnazistëve, si në retorikën e vendosjes së kërkesave të tyre, Komiteti vuri re përpjekje për ndërprerje të

<sup>1</sup> <http://mhc.org.mk/announcements/273#.VtYCNsvSldh>

<sup>2</sup> <http://mhc.org.mk/announcements/272#.VtYCI8vSldh>

bojkotit dhe negociatave nëpërmjet metodave të ndryshme të frikësimit dhe etiketimit të të rinjve në publik. Edhe përkrah numrit dhe relevancës juridike për pranim të ndryshimeve të ofruara në reforma nga të rinjtë, megjithatë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës vendosi t'i injorojë dhe të heshtë deri në ndërprerje të protestave.

Komiteti ka dhënë vërejtje edhe për negociatat të cilat janë mbajtur nga përfaqësuesit e Plenumit të Gjymnazistëve me Ministrin dhe zëvendësministrin e arsimit, Abdulrakim Ademin, Spiro Ristovskin dhe zëvendëskryeministrin Vlladimir Peshevskin. Përpjekjet për diskreditim të kërkesave të të rinjve si dhe të personalitetit dhe dinjitetit të tyre nuk ishin marrë parasysh. 20 minutat hapësirë për të shprehur qëndrimet në mbledhjen me kohëzgjatje prej 1 orë e 15 minutash përbënte mosrespektim të dispozitave të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, e cila në nenin 12 parashikon se fëmijës i cili është i aftë të formojë mendimin e vet personal i garantohet e drejta e shprehjes së lirë të mendimit për të gjitha të drejtat të cilat e tangojnë, duke i kushtuar vëmendjen e obliguar. Njëkohësisht, Komiteti i shqyrtoi bazat juridike të të rinjve dhe në tërësi i mbështet kërkesat për ndërprerje të testimit ekstrën si model. Komiteti rikujton se shtetet kanë obligim pozitiv ta mbrojnë të drejtën e fëmijëve dhe t'i edukojnë nëpunësit shtetërorë, publikë dhe policorë mbi të drejtën e fëmijëve për të protestuar me qëllim që të praktikohet më lehtë kjo e drejtë.<sup>3</sup>

Pas ndërprerjes së protestave me vendosjen e kampit përballë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave, nga Plenumi i Gjymnazistëve, kurse me mbështetje të Plenumit të Arsimtarëve ishte organizuar një marsh i madh i gjymnazistëve, ku për solidarizim u përfshinë edhe studentët. Pas këtij evenimenti, gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2015 të Komiteti i Helsinkit janë dorëzuar fletëparaqitje me gjetje për kërcënime mbi gjymnazistët, të cilët morën pjesë në marshin protestues të gjymnazistëve që u mbajt më 21.11.2015. Gjetjet janë dorëzuar nga gjymnazistët, por edhe prindërit. Sidomos janë shqetësuese gjetjet për mbylljen e nxënësve në klasa nga nëpunësit zyrtarë, nëpërmjet mbylljes së klasave dhe dyerve të shkollave të mesme, si dhe fakti që media të caktuara informuan se gjymnazistët kanë marrë kompensim në të holla për pjesëmarrje në këtë protestë. Kështu është kryer shkelje e nderit dhe reputacionit të fëmijëve të cilët duan ta shprehin pakënaqësinë nga reformat në arsim. Mandej, mbyllja e fëmijëve në klasa me qëllim që të mos marrin pjesë në marshin protestues është privim i jashtëligjshëm nga lira, i cili është i ndaluar në përputhje me Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë.<sup>4</sup>

<sup>3</sup> Obligimi pozitiv i shtetit për mbrojtje të veçantë të fëmijëve të cilët marrin pjesë në protesta vihet re edhe në praktikën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e Njeriut. Në rastin *Castleand Others v Great Britain* Gjykata Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve e përcakton të drejtën e fëmijëve që të marrin pjesë në protesta duke theksuar se duhet të konsiderohen si grup i lëndueshëm prandaj gjykata duhet t'u sigurojë ndihmë të veçantë, sidomos nga nëpunësit policorë gjatë praktikimit të kësaj të drejte.

<sup>4</sup> Në nenin 140 paragrafi 3 të Kodit Penal thuhet se "Nëse privimin e jashtëligjshëm nga liria e kryen një person zyrtar me keqpërdorim të pozitës apo autorizimit zyrtar, do të dënohet me burg nga gjashtë muaj deri në pesë vjet". Në bazë të këtij neni ekziston mundësia që Prokuroria Publike të veprojë sipas asaj që ka dëgjuar dhe t'i hetojë informacionet për privim nga liria të gjymnazistëve.

## III. GJYQËSORI

### 1. HYRJA

Komiteti i Helsinkit është një nga organizatat e rralla në Republikën e Maqedonisë e cila ka përvojë shumëvjeçare dhe të vazhdueshme në mbikëqyrjen e procedurave gjyqësore. Nëpërmjet programit të vet për ndihmë juridike pa pagesë, Komiteti ka mundësi të shqyrtojë listat të cilat janë pjesë përbërëse e lëndëve gjyqësore. Në këtë mënyrë, Komiteti i Helsinkit ka mundësi procedurat t'i mbikëqyrë si në aspektin juridiko-shkencor ashtu edhe në aspektin praktik. Gjatë vitit 2015 janë mbikëqyrur gjithsej 50 procedura gjyqësore, gjatë 132 seancave, nga materia penale dhe qytetare. Mbikëqyrja është zhvilluar në shtatë gjykata në shtet.

Përfundimi i përgjithshëm është se ekzistojnë ende probleme sistematike të cilat gjyqësori nuk arrin t'i tejkalojë, i tejkalon shumë ngadalë, ose i thellon. Problemet themelore janë në pavarësinë e pamjaftueshme të gjyqësorit nëpërmjet përzierjes së pushtetit ekzekutiv në atë gjyqësor, profesionalizmi dhe trajnimi i pamjaftueshëm i gjykatësve, mungesa e transparencës në gjykata, mungesa e konsistencës në praktikën gjyqësore, trajtimi i pabarabartë i organeve qytetare përkundrejt organeve shtetërore, kur ato shfaqen si pakë në procedura dhe mosekzistimi i mbrojtjes juridike efikase, sidomos nëpërmjet qasjes të drejtësisë, shkelja e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm dhe prezumimi i pafajësisë.

Te një numër i madh i procedurave gjyqësore shqetëson praktika e marrjes së vendimeve për përcaktim dhe vazhdim të masës së paraburgimit pa u argumentuar cilat janë shkaqet për këtë. Mbizotëron praktika e vazhimit të kolektiv të paraburgimit për grup të akuzuarish të cilëve u përmenden emrat, por vendimet nuk kanë pasqyrim individual mbi shkaqet për të cilat çdo të akuzuari më vete i vazhdohet masa e arrestit. Paraburgimi zgjat tej mase, madje dhe pas përfundimit të hetimit dhe marrjes në pyetje të të akuzuarve. Shqetëson fakti se nuk shfrytëzohen masa më të buta siç është garancia.

Qytetarët në Republikën e Maqedonisë kanë interes shumë të vogël të marrin pjesë në rolin e publikut. Publiku nuk është i informuar aspak mbi mënyrën se si mund të realizojë të drejtën e vet që të marrë pjesë në sallën e gjyqit gjatë procedurave gjyqësore. Ekziston praktika disa procedura gjyqësore të mbahen në kushte të papërshtatshme në zyrat e gjykatësve. Nuk është siguruar ende përfaqësimi i drejtë midis gjykatësve, pjesëtarë të bashkësive pakicë. Disa gjykatës kanë marrëdhënie të ndryshme ndaj pjesëmarrësve në procedura gjatë kësaj vihet re afërsia më e madhe me prokurorët publikë dhe statusi i privilegjuar ndaj avokatëve më të moshuar dhe më me përvojë. Vihet re praktika e lëshimit të sallës së gjyqit nga gjykatësit dhe gjykatësit porotë gjatë mbajtjes së seancës apo diskutimit kryesor.

Duke pasur parasysh kohën e gjatë për një pjesë të lëndëve të mbikëqyrura, por edhe ankesat e vazhdueshme të qytetarëve dhe vendimet të cilat i marrin nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë dhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut me të cilat u njihet shkelja e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm dhe përcaktohet kompensim i dëmit, mund të konstatohet mungesë e efikasitetit në veprimtarinë e gjykatave. Shqetëson sidomos fakti që nuk respektohen procedurat të cilat janë paraparë si urgjente, si në procedurën penale ashtu edhe në atë qytetare, të cilat ndikojnë në realizimin e të drejtave të tjera të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare. Në vijim të këtij teksti jepen rastet në të cilat është përcaktuar shkelje më e madhe e të drejtave dhe trysnia dhe përzierja e pushtetit ekzekutiv në atë gjyqësor.

## 2. RASTI TOMISLLAV KEZHAROVSKI

Gazetari Tomisllav Kezharovski është arrestuar në maj të vitit 2013 me dyshimin se në vitin 2008, nëpërmjet artikullit të botuar në revistën Reporter 92, e ka zbuluar identitetin e dëshmitarit të mbrojtur në rastin gjyqësor “Oreshe”. Sipas thënies së dëshmitarit, mbi të është ushtruar presion, që para gjykatës të japë deklaratë të përgatitur nga përfaqësuesit e policisë. Arrestimi ka ndodhur kur z. Kezharovski e ka hetuar vdekjen e dyshimtë në aksident automobilistik të gazetarit Nikolla Mlladenov dhe përkrah faktit që në vitin 2008 dëshmitari i rastit “Oreshe” ende nuk kishte status të mbrojtur. Pas arrestimit spektakular dhe dërgimit në Gjykatën Themelore Shkup 1 para kamerave të shumta të gazetarëve z. Kezharovski ishte dënuar me 4,5 vjet burgim, kurse në nëntor të vitit 2013, pas më tepër se 5 muaj të kaluar në paraburgim, i është shqiptuar masa arrest shtëpiak deri në hyrjen në fuqi të procedurës.

Pas shpalljes së vendimit të Gjykatës së Apelit në janar të vitit 2015 me të cilin dënimi prej 4,5 vitesh burgim për gazetarin Kezharovski ishte zvogëluar në 2 vjet, të njëjtën ditë nga MPB-ja, pas marrjes së aktit të lëshuar nga gjykata për zbatimin e sanksioneve, z. Kezharovski ishte dërguar të vuajë dënimin me burg pa iu dorëzuar aktvendimi gjyqësor. Edhe pse aktvendimi pas marrjes së tij nga Gjykata e Apelit është i plotfuqishëm (neni 127, paragrafi 1 i ligjit të vjetër, Ligji për Procedurë Penale, sipas të cilit mbahej lënda), pa dorëzim të tij te i akuzuari ai nuk është edhe ekzekutiv (neni 127 paragrafi 2 LPP), përkatësisht gjykatësi për zbatimin e sanksioneve nuk mund të miratojë akt drejtues për vuajtje të dënimit me burg.

Një ditë pas dërgimit në Burgun Shkup, drejtori i burgut i ka propozuar drejtoreshës së Drejtorisë për Zbatim të Sanksioneve ndërprerje të dënimit prej 30 ditësh për shkak të gjendjes shëndetësore të përkeqësuar të z. Kezharovski. Vendimi ishte pranuar edhe përkrah faktit që ai ishte i pranishëm në protestat e organizuara për shkak të burgimit të tij dhe ishte e dukshme se gjendej në gjendje të mirë shëndetësore. Ndërkohë, një propozim tjetër i drejtorit të burgut ishte që z. Kezharovski të lirohet nëpërmjet lirimit me kusht, Gjykata Themelore Shkup 1 e pranoi propozimin e tillë dhe ka marrë vendim pozitiv. Vendimi është ankimuar nga Prokuroria Themelore Publike Shkup, kurse Gjykata e Apelit Shkup më 17 shkurt 2015 e hodhi poshtë këtë ankesë.

Procesi i tërësishëm gjyqësor kundër gazetarit Kezharovski ishte një precedent serioz nëse kihet parasysh se në rajon nuk është vënë re rast gazetar të jetë dënuar me një dënim me burg kaq të lartë për arsye se i ka kryer aktivitetet gazetareske. Kjo, sidomos në kushte kur lira e mediave dhe liria e shprehjes në Republikën e Maqedonisë janë rrezikuar seriozisht, vendimi i tillë është edhe një mesazh për heshtje dhe censurë të gjithë atyre të cilët kanë qëndrim dhe mendim kritik. Një prej elementëve themelorë për të cilin Prokuroria Publike duhej të reagoonte në kohë dhe të zbatonte procedurë të re është kontrolli i të dhënave të dëshmitarit mbrojtës

në rastin “Oreshe”, sepse nëse përcaktohej vërtetësia e të dhënave të dëshmitarit të mbrojtur se deklarata e tij para gjykatës ishte fabrikuar nga policia, atëherë gazetari Kezharovski është si që zbuloi kryerjen e veprës penale, ndërsa nuk ka kryer një vepër të tillë.

Veprimi i tillë nga prokuroria dhe gjykatat rezultoi me kufizim të lirisë prej 597 ditësh (prej të cilave 162 ditë në paraburgim, kurse pjesën tjetër në burgim shtëpiak) dhe trysni psikike prej pothuajse dy vjetësh mbi gazetarin Kezharovski dhe mbi familjen e tij. Gazetari në evidencën e dënimit do të mbetet si kryerës i veprës penale, kurse historia e tij hulumtuese për ndikim të policisë mbi dëshmitarin e mbrojtur dhe fabrikimin e deklaratës me qëllim që të ndikojë mbi organet e drejtësisë mbetet të pa hetuara.

### 3. RASTI JADRANKA KOSTOVA

Vendimi nr. 08-214/1 i Komisionit për Verifikim të Fakteve më 26 mars 2015, me të cilën u bë lustracioni i gazetares Jadranka Kostova, ishte edhe një akt klasik i hakmarrjes politike kundër kundërshtarëve dhe kritikuesve të pushtetit aktual. Marrja e vendimit ka vijuar një javë pas emetimit të filmit dokumentar të titulluar “Maqedonia: pas fasadave” të dhënë në televizionin “Al Xhezira” ku gazetarja është redaktorja kryesore e të përjavshmes “Fokus” jep qëndrime kritike mbi ngjarjet në shtet. Data kur është marrë vendimi – 26 mars – është e njëjtë me datën kur në vitin 2013 ish redaktori kryesor i të përjavshmes “Fokus” ka humbur jetën në rethana të dyshimta në aksident rrugor.

Gjatë procedurës së lustracionit të gazetares Kostova, Komisioni ka përcaktuar se ajo me vetiniciativë është paraqitur që të jetë burim i njohurive për dy persona, të cilët ishin interesantë për shërbimin për shkak të politikës së tyre të ndryshme dhe përkatësisë tjetër. Si argumente për gjetjen e tillë Komisioni ka dhënë Rregulloren për Revizion të Dosjeve Personale të vitit 1967 (në atë kohë gazetarja ka nisur arsimin fillor). Shënimi profesional ishte prej vitit 1993 dhe Riprodhimi i një bisede të vitit 1996. Prej dy dokumenteve të fundit, Komisioni ka nxjerrë përfundimin se gazetarja Kostova, gjatë kohës kur ka punuar në MRTV, për shkaqe ideologjike apo politike, me vetëdije, në mënyrë sekrete, të organizuar dhe të vazhdueshme ka bashkëpunuar me organet për siguri të shtetit. Sipas Komisionit, gazetarja aktivitetet e tilla i ka ndërmarrë me qëllim që të përparojë në shërbim.

Në lidhje me shënimin zyrtar të vitit 1993, sipas gazetares Kostova, ajo është paraqitur në MPB dhe në DSK duke konsideruar se personi për të cilin demok ka informuar është pjesë e provokimit policor kundër saj për suspendimin e saj nga vendi i punës – redaktore e emisionit “Pa titull, por me shkas”, si dhe ndërprerjen e emisionit ku është diskutuar për tema tabu, si është shprehja e lirë e besimit të qytetarit i cili ka konsideruar se maqedonasit janë bullgarë. Në dokumentin Riprodhim i bisedës së vitit 1996 është dhënë një bisedë telefonike midis dy personave prej të cilëve njëri pohon se gazetarja ka qenë në Romë në shoqërim të shërbimeve sekrete, kurse personi tjetër nuk e beson këtë gjë. Gjetjet e Komisionit të nxjerra nga riprodhimi i bisedës ishin gjetje “më the-të thashë” dhe si të tilla të papërshtatshme që të përdoren si dëshmi, kurse akoma më pak si fakte.

Gjatë muajit prill 2015, pas sigurimit të ndihmës juridike nga Komiteti i Helsinkit, gazetarja Kostova ka ngritur padi kundër vendimit të Komisionit të Gjykatës Administrative. Në padi përmbahen të gjitha argumentet e përmendura, si edhe 6 (gjashtë) deklarata të vërtetuara në notar nga kolegët dhe bashkëpunëtorët e znj. Kostova, nëpërmjet të cilave dëshmohet padyshim se vendimi i Komisionit është i fabrikuar dhe se angazhimi profesional i saj si gazetar në asnjë rast nuk mund të konsiderohet si bashkëpunim i vetëdijshëm, sekret, i organizuar dhe i vazhdueshëm me organet e sigurimit shtetëror. Edhe përkrah faktit se nga ngritja e padisë kanë kaluar më tepër se 10 muaj dhe urgjencës së procedurës sipas Ligjit për Lustracion, Gjykatës Administrative nuk ka marrë vendim deri në përfundimin e këtij raporti.



Pas shpalljes së skandalit me bisedat e përgjuara në mënyrë jolegale, Kuvendi i RM-së, me propozim të Qeverisë së RM-së, në korrik të vitit 2015 e ka suspenduar procesin e lustracionit, por ai mbetet aktiv për të gjithë personat për të cilët është marrë vendim, deri në përfundimin e plotfuqishëm të procedurës. Edhe përkrah vijimit të tillë, mbetet përfundimi se procesi i pastrimit me të kaluarën duhej të bazohej në parimet e ligjshmërisë dhe drejtësisë. Në kundërshtim me këto postulate, lustracioni në Republikën e Maqedonisë ishte shndërruar në një shembull klasik për procedurë inkuizitore ku personat e akuzuar nuk janë dëgjuar aspak dhe nuk kanë mundësi të mbrohen. Si pasojë, për një sërë profesioneve si gazetarë, profesorë dhe të tjerë, rezultati i kësaj procedure ishte i njëjtë me sanksionin ndëshkues të Kodit Penal - ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrës. Nëse Gjykata Administrative në rastin e gazetares Kostova nuk e siguron sekretin e të dhënave personale, mbrojtjen e integritetit individual, respektimin e privatësisë, jetës familjare, dinjitetin dhe reputacionin, Komiteti i Helsinki është i bindur se drejtësia do të arrihet para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, siç ishte rasti edhe me lustracionin e ish-kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Trendafil Ivanovski.<sup>5</sup>

#### 4. RASTI FAMILJA ARSOVSKI

Komiteti i Helsinkit e ka ndjekur edhe procedurën e ekspropriacionit të pronës së familjes Arsovski në Kratovë e cila para gjykatave vendase dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) zgjat nga viti 2002. Prona familjare është marrë me propozim të kompanisë private e cila ka marrë lejë që të nxjerrë ujin që gjendet nën këtë pronë. Mundësia që kompanitë private të propozojnë ekspropriacion të pronës private që është me interes publik, në vitin 2009, nga Gjykata Administrative (U.nr. 200/2007) është vlerësuar si në kundërshtim me Kushtetutën e RM-së sepse mundësia një patundshmëri e caktuar të merret në dobi të shfrytëzuesve të fuqishëm ekonomikë, kurse interesi i mbartësit të të drejtës së pronësisë të minimizohet në mënyrë të tillë e vë në pikëpyetje të drejtën e pronësisë të garantuar me Kushtetutë.”

Pasi në vitin 2005 procedura e ekspropriacionit para gjykatave vendase përfundoi me marrjen e pronës nga shteti në dobi të kompanisë private, familja Arsovski ka marrë dëmshpërblim prej 880 eurosh, pa u marrë parasysh se kompania private realizon fitim nga eksploatimi i ujit. Të pakënaqur nga vendimet e gjykatave vendase, familja Arsovski në vitin 2006 ka dërguar ankesë në GjEDNj.

Në vitin 2013, GjEDNj ka marrë Aktvendimin nr. 30206/06 (Arsovski kundër Maqedonisë)<sup>6</sup> ku ka përcaktuar se shteti e ka shkelur të drejtën e pronësisë, të garantuar nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj). Mandej, GjEDNj ankuesve u ka përcaktuar 9 000 euro të cilat shteti ua ka paguar si shpenzime jomateriale, kurse në lidhje me shpenzimet materiale procedura ka ndaluar, por edhe nuk ka përfunduar në pritje se Aktvendimi do të përdoret për përsëritje të procedurës para gjykatave vendase për kthim eventuale të pronës apo për ekspropriacion të drejtë.

Pas marrjes së aktvendimit në vitin 2013 familja Arsovski ka kërkuar përsëritje të procedurës para Gjykatës Administrative kompetente e cila e ka pranuar kërkesën, kurse vendimin e mëparshëm në fuqi për ekspropriacion e ka anuluar (U-2 nr. 494/13). Gjatë vitit 2014 në procedurë si person i interesuar u përfshi edhe kompania “Sileks ShA” nga Kratova e cila ka dorëzuar ankesë para Gjykatës të Lartë Administrative e cila e ka pranuar ankesën dhe e ka obliguar Gjykatën Administrative ta shqyrtojë përsëri kërkesën për përsëritje të procedurës (Uzh-1 297/14). Gjykata e Lartë Administrative, midis të tjerave, thotë se “Për këtë gjykatë nuk është kontestuese se pas marrjes së vendimit nga GjEDNj gjykata ku është dorëzuar kërkesa për ndryshim

<sup>5</sup> [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-160219"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

<sup>6</sup> <http://goo.gl/XXTCGj>

të vendimit, është e obliguar të veprojë sipas kësaj kërkesë, por në varësi nga shkaqet për të cilat kërkohet përsëritja e procedurës do të vendosë se a do të lejojë përsëritje.”

Pas rivendimit për përsëritje të procedurës para Gjykatës Administrative në vitin 2014, Gjykata ka marrë vendim me të cilin kërkesa e familjes Arsovski në një pjesë e ka shpallur jo në kohë, kurse në një pjesë e ka shpallur si të pavlefshme (U-2 nr. 1278/14). Sipas Gjykatës Administrative, kurse në përputhje me nenin 47 paragrafi 2 i Ligjit për Konteste Administrative, në rastin konkret nuk mund të kërkohet përsëritje e procedurës sepse kanë kaluar pesë vjet nga hyrja në fuqi e vendimit me të cilin është zbatuar ekspropriacioni në vitin 2005. Vendimi i Gjykatës Administrative është vërtetuar me Vendimin e Gjykatës Administrative të Larë në vitin 2015 (U-1 nr. 199/2015).

Komiteti i Helsinkit shpreh shqetësim për vendimin e tillë të Gjykatës Administrative dhe Gjykatës të Lartë Administrative. Domethënë edhe përkrah faktit se është e vërtetë se përsëritje e procedurës sipas Ligjit për Konteste Administrative mund të bëhet në afat prej 5 vjetësh nga hyrja në fuqi e aktit juridik të ankimuar, gjykatat administrative kanë neglizhuar se në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës së RM-së marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen në përputhje me Kushtetutën janë pjesë e rendit të brendshëm juridik dhe nuk mund të ndryshojnë me ligj. Kjo në praktikë do të thotë se fuqia juridike e KEDNj-së është mbi fuqinë juridike të ligjeve, përkatësisht nëse në një situatë ekziston konflikt midis të drejtës vendase dhe asaj ndërkombëtare, organet shtetërore duhet të mbështeten në dispozitat e të drejtës ndërkombëtare. Dispozitat që lidhen me vjetërsimin të përcaktuara nëpërmjet ligjeve për procedura penale dhe kontestuese dhe Ligjin për Konteste Administrative duhet të ndryshojnë në mënyrë të tillë që afatet për fillim të vjetërsimit duhet të vijojnë nga aktvendimi fuqiplotë i GjEDNj-së, ndërsa jo nga plotfuqia e aktit përfundimtar të shqiptuar në gjykatat vendase.

## 5. RASTI JASMINKA ANGELLOVA

Komiteti i Helsinkit e ndjek procedurën gjyqësore të paditëses private Jasminka Angellova, bashkëshortja e liderit të partisë politike Dostoinstvo, për shkak të lëndimit trupor nga nëpunësi policor në protestën e mbajtur më 8 maj 2015.

Gjatë procedurës, e cila ende është në fazën e pajtimit, gjykata e ka dënuar paditësen private me shumë në të holla prej 500 eurosh sepse e ka ofenduar gjykatën. Domethënë, gjykatësja ka konsideruar se statusi i vendosur në Fejzbuk në profilin privat të paditëses ku ka deklaruar se i akuzuari nuk shfaqet në gjykimet e vendosura dhe gjykata nuk ka qenë në vijim me lëndën është ofendim për gjykatën. Për vendimin e tilla ka ndikuar fakti se statusi në Fejzbuk është mare nga internet-portali “Naroden glas”, prandaj gjykatësi ka konsideruar se bëhet fjalë për kolumnë.

Vendimi i tillë është ankimuar nga paditësja dhe Këshilli Penal vendosi ta vlerësojë ankesën dhe ta ndalojë vendimin kontestues. Në vendimin e vet Këshilli Penal ka vendosur se është e paqartë se në cilën mënyrë dhe me cilat fjalë paditësja e ka ofenduar gjykatën, sepse nuk ka fjalë ofenduese në statusin e saj në Fejzbuk, që mandej është mare nga një internet-portal. Mandej për gjykatën është e paqartë se si gjykatësi ka përcaktuar se paditësja e ka ofenduar të akuzuarin, sepse është e qartë se nuk ka ekzistuar pajtueshmëri për marrje të statusit të saj nga internet-portali “Naroden gllas”.

## 6. SHKELJA E TË DREJTËS PËR GJYKIM NË AFAT TË ARSYESHËM

Komiteti i Helsinkit e ka vërtetuar përsëri shkelje të së drejtës gjykim në afat të arsyeshëm në kontestin gjyqësor për anulim të vendimit për pushim nga puna. Në rastin konkret bëhet fjalë për person i cili në cilësi të

paditësit ka pasur procedurë gjyqësore prej 3,5 vjetësh për anulim të vendimit për pushim nga puna të dhënë nga institucioni ndëshkues-edukues ku ka punuar. Në periudhën kohore prej 3,5 vjetësh, Gjykata Themelore Shkup 2 Shkup njëherë e ka shfuqizuar vendimin kontestues për pushim nga puna, por meqenëse ky vendim është anuluar nga Gjykata e Apelit Shkup, është marrë vendim negativ për paditësin, që është vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë. Që ta marrë vendimin e parë gjykata e shkallës së parë ka pasur nevojë për një vit e 7 muaj, edhe pse procedurat e marrëdhënieve të punës para gjykatës së shkallës së parë duhet të përfundojnë në afat prej 6 muajsh nga dorëzimi i padisë.

Gjykata e shkallës së dytë, ka vepruar me ankesë të paditësit më tepër se 1 vit e 2 muaj, edhe pse procedurat para gjykatës së shkallës së dytë duhet të përfundojnë në afat, maksimum, prej 30 ditësh nga dita e marrjes së ankesës, përkatësisht në afat prej 2 muajsh nëse para gjykatës së shkallës së dytë mbahet seancë. Për shkak të shkeljes së dukshme të të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, paditësi ka dorëzuar kërkesë për mbrojtje të Gjykata e Lartë e Republikës së Maqedonisë, e cila është pranuar dhe i është gjykuar kompensim i drejtë në shumë prej 30,000 denarësh. Gjykata ka përcaktuar shkelje të legjislacionit nacional, por edhe të dispozitave të Konventës për të Drejtat e Njeriut. Domethënë në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut thuhet se “Secili ka të drejtë që në mënyrë të drejtë dhe publike, në afat të arsyeshëm, para një gjykate të pavarur dhe të paanshme të vendosur me ligj, t’i shqyrtohen dhe përcaktohen të drejtat dhe obligimet e tij qytetare.”

## 7. VENDIME TË NDRYSHME NË GJYKATA TË NDRYSHME PËR NJË NGJARJE TË NJËJTË JURIDIKO-PENALE

Publiku është informuar për rastin e viktimës nga dhuna familjare dhe rrëmbimi në Kriva Pallankë, e cila mandej u bë e akuzuar në procedurën për veprën penale paraqitje të rreme të të njëjtës ngjarje. Ky rast është vetëm edhe një shembull si viktimizohen viktimat e dhunës familjare nga vetë sistemi i cili duhet t’i mbrojtë ato.

Domethënë, viktima është ndjekur nga prokuroria publike në Kriva Pallankë për dhënie të dëshmisë së rreme se ish-partneri i saj ka kryer veprat penale përdhunim dhe grabitje, edhe pse për të njëjtën ngjarje juridiko-penale personi është paraqitur si paditës subsidiar në Gjykatën Themelore Kumanovë. Duke vepruar sipas propozimit të tillë, Gjykata Themelore në Kriva Pallankë ka marrë vendim me të cilën përcaktohet faji i viktimës për dhënie të deklaratës së rreme, i cili mandej është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit në Shkup.

Në procedurën e dytë për të njëjtën ngjarje, që është mbajtur në Gjykatën Themelore Kumanovë, ku viktima paraqitet si paditës subsidiar, gjykata ka marrë vendim me të cilin e shpall fajtor të njëjtin person i cili paraqitet si i dëmtuar në procedurën e dhënë më sipër që është mbajtur në Gjykatën Themelore Kriva Pallankë. Ky vendim nuk është ende i plotfuqishëm.

Për shkaqet e dhëna më sipër viktima ka dorëzuar kërkesë për ligjshmëri te Prokuroria Publike në RM, për të cilën nuk ka marrë ende përgjigje.

Komiteti i Helsinkit shpreh shqetësimin për veprimin e tillë të gjykatave themelore në Kriva Pallankë dhe Kumanovë sepse për të njëjtën ngjarje juridiko-penale janë marrë vendime krejtësisht të kundërta, kurse kështu shkelet parimi i sigurisë juridike.

## IV. KUSHTETUTA DHE LIGJVËNIA

### 1. LIGJI PËR KËSHILLIN PËR PËRCAKTIM TË FAKTEVE DHE NGRITJEN E PROCEDURËS PËR PËRCAKTIM TË PËRGJEGJËSISË SË GJYKATËSIT

Më 11 shkurt 2015, me procedurë të shkurtër dhe pa diskutim profesional dhe publik Kuvendi i RM-së e ka miratuar Ligjin për Përcaktim të Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktim të Përgjegjësisë së Gjykatësit. Këshilli për Përcaktim të Fakteve është paraparë si një trup i ri gjykues, i cili ka për qëllim të ndërmarrë një pjesë të punës së Këshillit Gjyqësor të RM-së. Kompetenca kryesore e Këshillit për Përcaktim të Fakteve lidhet me ngritjen e procedurës disiplinore dhe procedurës për punë pa profesionalizëm dhe të shkujdesur të gjykatësve para Këshillit Gjyqësor të RM-së. Këshilli për Përcaktim të Fakteve do të ketë mundësi t'i rrëzojë iniciativat për përcaktim të përgjegjësisë, pas këtij veprimi, vendimit i tij bëhet përfundimtar, përkatësisht iniciativat e rrëzuara nuk do të shqyrtohen aspak nga Këshilli Gjyqësor i RM-së.

Këshilli për Përcaktimin e Fakteve do të përbëhet nga 9 anëtarë të cilët është obligueshme të jenë juristë në pension dhe kjo 3 gjykatës, 3 prokurorë publikë, 2 profesorë të së drejtës dhe 1 avokat. Përveç asaj që të gjithë anëtarët duhet të jenë në pension, është e nevojshme që ata të kenë stazh të pandërprerë prej 15 vjetësh, të kenë rezultate të shquara në punën e vet dhe të mos kenë pasur sanksione disiplinore. Mandati i anëtarëve të zgjedhur është katër vjet pa të drejtë për t'u rizgjedhur. Minimum 1/3 e anëtarëve është paraparë të jenë përfaqësues të bashkësive të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë. Kandidatët për në Këshillin për Përcaktim të Fakteve do të paraqiten në shpallje publike, kurse do të zgjidhen nga të gjithë gjykatësit në zgjedhje të drejtpërdrejta dhe të fshehta.

Më 10 korrik 2015, në votimin për zgjedhje të Këshillit për Përcaktim të Fakteve, nga 594 gjykatës gjithsej, votuan 535, kurse ishin të pavlefshme 160 fletëvotimi. Janë zgjedhur 7 anëtarë të Këshillit, kurse edhe një anëtar ishte zgjedhur më 28 dhjetor 2015 kur prej 573 gjykatësve të regjistruar në Listën zgjedhore të gjykatësve votuan 502 gjykatës, kurse fletëvotimi të pavlefshme ishin 67. Deri në përfundim të këtij raporti, ende nuk është zgjedhur anëtari i fundit, anëtari i nëntë, i cili duhet të jetë nga radhët e profesorëve të pensionuar, përfaqësues i bashkësive joshumicë. Numri i madh i fletëve të pavlefshme të votimit flet qartë për qëndrimin e gjykatësve të cilët nuk janë dakord me ekzistimin dhe funksionimin e një Këshilli për përcaktim të fakteve të përfytyruar në mënyrë të tillë.

Miratimi i këtij ligji dhe puna e Këshillit për Përcaktim të Fakteve është kontestuese në dy aspekte. Së pari, mundësia e Këshillit për Përcaktim të Fakteve të rrëzojë iniciativa dhe vendimi i tillë të jetë përfundimtar është në kundërshtim me Amendamentin XXIX të Kushtetutës së RM-së ku është përcaktuar se një pjesë

e kompetencave të Këshillit Gjyqësor të RM-së janë që ai të ndjekë dhe vlerësojë punën e gjykatësve dhe të marrë vendime mbi përgjegjësinë e tyre disiplinore. Domethënë, Këshilli Gjyqësor i RM-së nuk do të ketë mundësi t'i shqyrtojë iniciativat e anuluaras kështu që ankimet kundër një numri të madh gjykatësish do të përfundojnë para Këshillit për Përcaktim të Fakteve. Roli i tillë i Këshillit për Përcaktim të Fakteve është jokushtetues, duke pasur parasysh se ky organ, për dallim nga Këshilli Gjyqësor i RM-së, nuk është paraparë në Kushtetutën e RM-së. Si rezultat i këtij ligji do të suspendoheshin një pjesë e kompetencave kushtetuese të Këshillit Gjyqësor të RM-së. Së dyti, kushti se vetëm gjykatës, prokuror, profesorë dhe avokatë në pension mund të jenë anëtarë të Këshillit për Përcaktim të Fakteve është i barabartë me diskriminimin e drejtpërdrejtë në bazë të moshës dhe është në kundërshtim me nenin 32 të Kushtetutës ku është paraparë se secili, në kushte të njëjta ka qasje të cilido vend pune.

Kushtetutshmëria e këtij Ligji është kontestuar para Gjykatës Kushtetuese, e cila në nëntor të vitit 2015 me vendimin U.nr. 23/2015 e ka hedhur poshtë iniciativën dhe nuk ka ngritur procedurë me arsyetimin se vlerësimi i përshtatshmërisë të vendimit të tillë ligjor është në kompetencë të ligjvënësit dhe jo të Gjykatës Kushtetuese, e cila është kompetente të vlerësojë a janë në përputhje me Kushtetutën ligjet ekzistuese. Megjithatë, gjykatësja, Natasha Gaber Damjanovska, në mendimin e vet të veçantë thotë se “Vendimi i tillë ligjor nuk posedon justifikim të arsyeshëm dhe jep pabarazi përkatësisht diskriminim të kategorisë së personave të cilët ende nuk e kanë marrë të drejtë të pensionit, kurse janë aspirues për funksionin publik anëtar i Këshillit për Përcaktim të Fakteve, përkundrajt kategorisë së personave të cilët tashmë janë në pension.”<sup>7</sup> Mandej, nga fundi i vitit 2015, Komisioni i Venecias i cili e ka analizuar Ligjin bëri thirrje për revizion të tërësishëm të kornizës ligjore për masat disiplinore dhe shkarkimin e gjykatësve. Edhe pse Këshilli për Përcaktim të fakteve duhej të fillonte punën në janar të vitit 2016, deri në përfundim të raportit kjo nuk është kryer.

## 2. ZGJEDHJA JOKUSHTETUESE E MINISTRIT TË PUNËVE TË BRENDSHME

Më 12 maj 2015, si rezultat i skandalit me bisedat e përgjuara në mënyrë jolegale, kryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, të Kuvendi i RM-së dorëzoi shkresë me të cilën i informoi dorëheqjet e ministrit të punëve të brendshme dhe ministrit të transportit. Në shkresë ishte edhe propozimi për ministrin e ri për punë të brendshme, kurse personi i propozuar për funksionin ishte Mitko Çangov, ish-drejtori i Byrosë për Sigurinë Publike në MPB. Nga biografia e shkurtër e z. Çangov, ai në periudhën prill 2012 deri në maj 2013 ka punuar në vendin e punës “shëf i shërbimeve qendrore policore në Byronë për Sigurinë Publike në MPB”.

Në përputhje me nenin 97 të Kushtetutës së RM-së, me organet e institucioneve shtetërore në fushën e mbrojtjes dhe policisë udhëheqin persona civilë të cilët drejtpërdrejt para zgjedhjes në ato funksione kanë qenë civilë minimum tre vjet. Organi i institucionit shtetëror në fushën e policisë është MPB-ja, kurse person udhëheqës është ministri i punëve të brendshme. Sipas kësaj, që të zgjidhet ministër, z. Çavkov duhej të ishte person civil që në prill të vitit 2012. Duke pasur parasysh se deri në maj të vitit 2013 ai ka qenë shëf policie, del se z. Çavkov nuk e përmbush kushtin e paraparë në nenin 97 të Kushtetutës së RM-së.

Komiteti kujton se në vitin 2004, para Gjykatës Kushtetuese të RM-së, e kundërshtoi përzgjedhjen e z. Siljan Avramovskit si ministër të punëve të brendshme. Shkaku i kundërshtimit ishte angazhimi i punës së z. Avramovski së pari si ndihmësdrejtor, kurse më vonë (në afat prej 3 vjetësh para emërimit) edhe drejtor i Drejtorisë për Sigurim dhe Kundërzbulim. Për fat të keq, me Vendimin U. nr. 127/2004, Gjykata Kushtetuese u shpall si jokompetente të vendosë në lidhje me këtë pyetje dike thënë se është e drejtë e Kuvendit t'i zgjedhë

<sup>7</sup> <http://goo.gl/1G0p4q>

ministrat në Qeveri dhe se vendimi për zgjedhje sipas karakterit dhe përmbajtjes së vet është akt i veçantë, me të cilin nuk rregullohen marrëdhënie midis një numri të pacaktuar subjektesh me mënyrën e përgjithshme dhe e njëjta nuk është dispozitë.

Komiteti i Helsinkit konsideron se pranimi i propozimit të kryeministrit nga shumica e deputetëve është shkelje e qartë, e vetëdijshme dhe e padyshimtë e Kushtetutës së RM-së. Komiteti thekson se vendimi i përmendur i Gjykatës Kushtetuese nuk duhej të përdorej si arsye për zgjedhjen jokushtetuese të ministrit të ardhshëm për punë të brendshme.

## V. INSTITUCIONE TË MBYLLURA DHE VEPRIMI POLICOR

### 1. HYRJA

Duke ndjekur gjendjet me institucionet e mbyllura dhe veprimet e policisë, Komiteti i Helsinkit konstaton se nuk është vënë re asnjë përparim në mbrojtjen e të drejtave të personave të vendosur institucione të mbyllura dhe gjatë këtij viti, as pas veprimit të policisë. Përkundrazi, jemi dëshmitarë të thyerjes sistematike të drejtave, integritetit fizik dhe dinjitetit të qytetarëve nga organet e shtetit. Edhe pse qasja e Komitetit të Helsinkit në burgjet është ende problem, informacionet për kushtet dhe trajtimin janë marrë nëpërmjet të burgosurve të cilët i janë drejtuar Komitetit të Helsinkit për ndihmë juridike. Gjetjet në këtë fushë, gjithashtu, bazohen në vendimet gjyqësore, treguesit statistikorë dhe rastet e mbuluara nga mediat, të cilat Komiteti i Helsinkit i ndjek dhe i kontrollon.

Burgjet dhe institucionet psikiatrike, si dhe institucionet e llojit të mbyllur, ballafaqohen me kushte substandarde për jetën, në kundërshtim me shumicën e dokumenteve ndërkombëtare dhe vendase. Një prej problemeve themelore i cili mbijeton më tepër vite është mbingarkesa, që e rrezikon privatësinë, kurse njëkohësisht e shkatërron dinjitetin e njerëzve, duke i çuar në kushte jonjerëzore dhe johumane për jetën në institucione të mbyllura. Mekanizmat për mbikëqyrje të këtyre institucioneve janë pothuajse jofunksionale, edhe pse kompetenca e tyre parashikon ndërmarrjen e hapave të rëndësishëm për përparimin e gjendjeve dhe mbrojtjen e të drejtave të personave në këto institucione. Mandej, trajtimi të cilët e marrin personat shumë shpesh është çnjerëzor që është në kundërshtim me parimin e ndalimit absolut të torturës nga institucionet. Mandej, ushtruesit e torturës mbeten të padënuar, që jo vetëm që nuk e pengon sjelljen e tillë, por mandej edhe e nxit.

Në një rritje të theksuar është vënë re përdorimi i forcës fizike të jashtëzakonshme nga nëpunësit policorë, për çka flet edhe fakti se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka shqiptuar pesë vendime kundër Republikës së Maqedonisë gjatë vitit 2015. Në këto vendime, vihet re se ka shkelje të mbrojtjes procedurale dhe thelbësore e cila sigurohet me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Me fjalë të tjera, jo vetëm që nëpunësit policorë kanë ushtruar procedura çnjerëzore dhe johumane kundër qytetarëve, por mekanizmat për kontroll të brendshëm në asnjë rast nuk kanë arritur të përcaktojnë sjellje joligjore të nëpunësve policorë dhe të zbatojnë hetim efektiv. Gjendja e tillë është pasojë e punësimit të tej mase të nëpunësve të rinj policorë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që ka për qëllim zmadhim në kuantitet në llogari të cilësisë së kuadrit të punësuar.

Gjendjet e vëna re në atë fushë gjatë vitit 2015, të çojnë në përfundimin se ndalimi absolut i torturës nuk respektohet në Republikën e Maqedonisë. Komiteti i Helsinkit apelon që të kushtohet vëmendje më e

madhe në institucionet e mbyllura, por edhe të merren ndryshime urgjente dhe thelbësore për mbindërtimin edukativ të nëpunësve zyrtarë të cilët zbatojnë autorizime si dhe të sanksionohen të gjitha rastet e përdorimit të panevojshëm dhe jashtë mase të forcës fizike.

## 2. RASTI LEON RAPOSKI – TRAJTIMI JOHUMAN I IP ENTI PËR MBROJTJE DHE REHABILITIM “Banja Banjsko”

Rasti i fëmijës shurdhmemec – viktimë e trajtimit johuman nga IP Enti për Mbrojtje dhe Rehabilitim “Banja Banjsko” e ka tronditur publikun dhe ishte lëndë e vëmendjes së veçantë nga Komiteti. Njohuritë për rastin janë marrë nga raporti i Avokatit të Popullit, i cili gjatë vizitës në Entin për Mbrojtjen e Rehabilitimit “Banja Banjsko” ka vërtetuar trajtim johuman mbi fëmijën, i cili është gjetur i lidhur në shtrat me arsyetimin se nuk mund të kontrollohet në mënyrë tjetër. Për këtë rast Komiteti i Helsinkit ka ngritur fletëparaqitje penale te Prokuroria Themelore Publike në Strumicë, kundër drejtoreshës së Qendrës për Punë Sociale në Manastir, kundër drejtoreshës së Entit për Rehabilitim “Banja Banskò” dhe personave të cilët ishin përgjegjës të drejtpërdrejtë për Leon në këto institucione, për kryerjen e veprave penale “mundim dhe veprim tjetër i ashpër, çnjerëzor apo ofendues dhe dënim” dhe “keqtrajtim gjatë ushtrimit të shërbimit”, Fletëparaqitja penale është rrëzuar nga Prokuroria Themelore Penale në Strumicë me arsyetimin se veprat e paraqitura nuk ndiqen me obligim zyrtar si edhe se lidhja e fëmijës ishte për shkaqe të arsyeshme të sigurisë. Vendimi i tillë mandej ishte vërtetuar edhe nga Prokuroria Publike e Lartë në Shtip. Për këto arsye Komiteti i Helsinkit ka dorëzuar Kërkese për ndërmarrje të ndjekjes penale te Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë i cili nuk arriti të përcaktojë shkelje të të drejtave të fëmijës dhe trajtim johuman dhe i vërtetoi vendimet e mëparshme të prokurorisë.

Për këto arsye Komiteti i Helsinkit dorëzoi aplikim te Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në emër të Leon Rapovskit për shkelje të nenin 3 të Konventës i cili lidhet me ndalimin e torturë dhe sjelljes johumane dhe nenin 13 i cili lidhet me të drejtën e ankesës reale. Aplikimi ishte e pranuar nga gjykata dhe procedura është në vijim.

## 3. INICIATIVA PËR MIRATIM TË LIGJIT PËR AMNISTI

Gjatë muajit shtator 2015 filloi mbledhja e 10 000 nënshkrime nga qytetarët për ngritjen e iniciativave qytetare për miratim të Ligjit për Amnisti. Propozimi i ligjit parashikon çlirim prej vuajtjes së 40% të dënimit me burg për të gjithë personat e dënuar, çlirim të tërësishëm të personave të cilët për herë të parë janë dënuar me dënim me burg deri në gjashtë muaj, çlirim prej 50% të dënimit të shqiptuar prej gjashtë deri në dymbëdhjetë muaj dhe çlirim të tërësishëm të cilat kanë mbushur 75 vjet. Iniciativa ishte e suksesshme, kurse votat e domosdoshme ishin mbledhur për një muaj jo të plotë. Megjithatë, Kuvendi i RM-së në nëntor të vitit 2015 nuk e miratoi ligjin e propozuar, kurse në dhjetor të vitit 2015 nuk ishte miratuar as propozimi për Ligjin për Amnisti i deputetëve Pavle Trajanovit dhe Liljana Popovskës.

Ligji i fundit për amnisti të personave për të cilët vendimi është i plotfuqishëm në Republikën e Maqedonisë është miratuar në vitin 1999 (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 6/99), përkatësisht para më tepër se 17 vjetësh. Në rajonin e Ballkanit Perëndimor ligje për amnisti të popullatës së përgjithshme të burgosur është marrë në Serbi (2012), Kosovë dhe Mali i Zi (2013). Në varësi nga shteti, ato ligje lidhen me çlirimin prej 25% prej dënimit me burg, kurse nuk lidhen me vepra penale të caktuara siç janë për shembull forma më të rënda të vrasjes,



prodhimtarisë dhe vënien në qarkullim të drogave, vepra penale që lidhen me keqpërdorim seksual, krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe veprat penale që përmbahen në të drejtën ndërkombëtare humanitare.

Duke pasur parasysh periudhën e gjatë që nga miratimi i Ligjit për Amnisti, mbingarkimin e madh të burgjeve dhe mosrespektimin e të drejtave themelore njerëzore të personave të dënuar, Komiteti i Helsinkit konsideron se miratimi i Ligjit për Amnisti është masë e domosdoshme dhe përkatëse. Megjithatë, konsiderojmë se për miratimin e një ligji të tillë është i domosdoshëm debat publik më i gjerë ku duhet të përfshihen të gjitha palët e prekura, duke përfshirë edhe institucione dhe organizata shtetërore, shkencore dhe qytetare. Debatit publik duhet të organizohet në drejtim të gjetjes së modelit më përkatës për amnisti, gjetjes së vlerësimit të rreziqeve të zmadhimit të mundshëm të recidivizmit, por edhe përcaktimit të shkaqeve për mbingarkesë, për politikë jofunksionale për resocializim dhe përmirësim të kushteve ku vuhet dënimi me burg.

#### 4. PUNËSIMI I 600 POLICËVE TË RINJ NË MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME

Më 10 korrik 2015 MPB-ja ka botuar shpallje për punësim të 652 ushtruesve, prej të cilëve 600 në vendin e punës "Polic". Shpallja vijonte pas shpalljeve për punësim të 300 policëve në vitin 2012 dhe 400 policëve në vitin 2013. Sipas kësaj, për 3 vjet, MPB do të paraqitet si punëdhënës i 1.300 policëve të rinj. Në nëntor të vitit 2013 Komiteti i Helsinkit i ka dërguar MPB-së kërkesë për informacione për numrin e përgjithshëm të të punësuarve në këtë ministri. Sipas përgjigjes, ai numër ishte 10.755 prej të cilëve 6.570 janë nëpunës të uniformuar policorë, kurse të punësuarit e tjerë janë persona të autorizuar të pauniformuar, nëpunës shtetërorë dhe personeli teknik.

Duke pasur parasysh këto të dhëna lidhur me numrin e të punësuarve para nënshkrimit të marrëveshjeve për punësim me kadetët prej shpalljeve të botuara në vitin 2012 dhe në vitin 2013, numri i policëve të uniformuar në Republikën e Maqedonisë ishte maksimum 7.297 (numri real është ndoshta pak më i vogël, duke pasur parasysh se një pjesë e policëve në një vit e gjysmë e kanë përbushur kushtin për pensionim). Nëse këtij numri i shtohet dhe numri i ri i paraparë prej 600 policësh, numri i përgjithshëm i të punësuarve në MPB do të tejkalojë 11.000, kurse numri i policëve të uniformuar do të jetë rreth 7.900.

Këta numra të çojnë te përfundimi se MPB-ja është punëdhënësi më i madh në Maqedoni dhe se për çdo 100.000 banorë do të angazhoheshin përafërsisht 395 policë (sipas regjistrimit vitit 2002). Sipas hulumtimit të Kombeve të Bashkuara, numri mesatar i këtij raporti në botë është 300.8 Në lidhje me numrin e përgjithshëm të të punësuarve në MPB, sipas statistikave të Eurostatit, MPB-ja e Maqedonisë gjendet në vendin e tretë sipas numrit të të punësuarve.<sup>9</sup> Statistikat lidhen me 38 shtete evropiane, kurse më tepër të punësuar ka vetëm në Qipro dhe në Malin e Zi.

Shqetëson sidomos fakti që gjatë botimit të shpalljeve MPB-ja nuk jep asnjë lloj arsytimi cila është nevoja për rritjen e numrit edhe kështu të madh të të punësuarve. Mandej, qytetarët nuk janë informuar për implikimet financiare të këtyre punësimeve të cilat në masë të madhe e rëndojnë buxhetin shtetëror. MPB-ja përveç asaj që nuk konsultohet me bashkësinë nuk vepron as në përputhje me Strategjinë për Reforma në Polici të Qeverisë së RM-së të vitit 2003 dhe me Aneksin e saj të vitit 2004 nëpërmjet të cilit parashikohet zvogëlim i numrit të të punësuarve në 7.200 persona, prej të cilëve 6.00 do të ishin nëpunës policorë të uniformuar.

E gjithë kjo, së bashku me stërvitjen e pamjaftueshme prej 12 muajsh të kadetëve, që është e drejtuar kryesisht ndaj përvetësimit të njohurive teorike, flet për politizimin dhe partizimin e MPB-së. Për të gjitha

<sup>8</sup> UN: Twelfth United Nations Congress on Crime Prevention and Criminal Justice, Salvador, Brazil, 12-19 April 2010, State of crime and criminal justice worldwide, f. 19.

<sup>9</sup> EUROSTAT: File: Police officers, average per year, 2007-09 and 2010-12 (per 100 000 inhabitants).

shkaqet e dhëna, Komiteti i Helsinkit i bëri thirrje MBP-së që ta tërheqë shpalljen publike dhe në vend të kuantitetit dhe punësimit të kuadrove partiakë t'i kushtojë vëmendje profesionalizmit të policisë dhe numrin e të punësuarve ta harmonizojë me numrat e parashikuar në Strategjinë për Reforma në Polici. Edhe përkrah thirrjes, më 4 gusht 2015, MPB-ja botoi se në shpallje janë paraqitur mbi 2 600 kandidatë me çka filloi përzgjedhja e zyrtare e policëve të rinj.

## 5. MOSDËNIMI I TORTURËS NË BURGJE NGA POLICIA

Gjatë vitit 2015, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg ka marrë 5 (pesë) vendime rekorde që lidhen me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut – Ndalimi i torturës. Në të gjitha vendimet bëhet fjalë për torturë të kryer nga nëpunës shtetërorë, por edhe përkrah faktit se këto raste janë paraqitur në prokurori, për to ose nuk ka pasur kurrfarë hetimi, ose hetimi ka qenë tërësisht joefektiv prandaj të dëmtuarit në një pjesë të rasteve lanë ngritur padi private të cilat janë hedhur poshtë ose nuk janë shqyrtuar sa duhet nga gjykatat. Për shkak të veprimit të tillë nga prokuroritë dhe gjykatat, janë shkelur rëndë të drejtat e personave që kanë ngritur ankesë, kurse Republika e Maqedonisë vetëm në bazë të këtij neni të konventës është dënuar me rreth 50.00 Euro, mjete që duhen t'u paguhen të dëmtuarve.

Në lëndën Asllani kundër Maqedonisë (Ankesa nr. 24058/13) një i punësuar në furrë në Resnjë, në vitin 2008 nga nëpunësi i policisë është shoqëruar në Stacionin policor në Resnjë, për shkak se ka punuar jolegalisht në këtë furrë. Në stacionin policor z. Asllani është keqtrajtuar dhe fyer, si nga ana psikike ashtu edhe fizike sepse i janë bërë lëndime trupore. Një prej nëpunësve policorë në këtë rast më vonë është bërë kryetar i Komunës së Resnjës. Edhe pse rasti është paraqitur në prokurorinë kompetente dhe në Sektorin për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale, nuk ka ndodhur asnjëherë një hetim efektiv, kurse si rrjedhim nuk ka pasur as gjykim. Në këtë rast Maqedonia është ndërtuar me 11.700 euro zhdëmtim për ankuesin.

Në lëndën Hajrullahu kundër Maqedonisë (Ankesa nr. 37537/07), z. Hajrullahu në vitin 2005 është kidnapuar dhe mbajtur në izolim tri ditë në shtëpi, një vend për arrest jashtë çdo praktike gjyqësore, që është organizuar në mënyrë sekrete dhe është kryer nga forcat e sigurimit të Republikës së Maqedonisë. Ai aty është keqtrajtuar nga policia, kurse edhe pse rasti më vonë është paraqitur, nuk ka pasur hetim efektiv për pohimet e tij për keqtrajtim as për pohimet se vendime e tij janë bazuar në pohimin e marrë me dhunë. Në këtë rast Maqedonia është dënuar me 8.010 euro zhdëmtim për ankuesin.

Në lëndën Andonovski kundër Maqedonisë (Ankesa nr. 24312/10) Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka marrë një aktvendim nëpërmjet të cilit është përcaktuar se Maqedonia e ka shkelur Konventën për të Drejtat e Njeriut sepse nuk ka siguruar mbrojtje nga tortura dhe nuk është ballafaquar në mënyrë përkatëse dhe efektivitet me rastet e torturës në territorin e vet. Kjo lëndë lidhet me kirurgun nga Kumanova i cili është rrahur nga policia dhe ka marrë lëndime të shumta trupore. Edhe pse ai ka dorëzuar kallëzim penal për këtë rast, Prokuroria Publike Themelore Kumanovë e ka hedhur poshtë se kinse nuk ka pasur dëshmi të mjaftueshme. Edhe pse z. Andonovski ka bërë padi penale private, gjykatat i kanë kushtuar pak vëmendje rastit të tij i cili ka përfunduar demok me tërheqjen e padisë së tij, pas së cilës ai duhej t'i paguante shpenzimet për procedurën. Gjykata Evropiane ka nxjerrë përfundimin se shteti nuk ka mundur ta arsyetojë përdorimin e forcës së paarsyeshme dhe jashtë mase nga policia, duke pasur parasysh faktin se prokuroria ka refuzuar të bëjë ndjekje për shkelje të nenit 3 (mbrojtje nga tortura) të Konventës Evropiane. Në këtë rast Maqedonia është dënuar me 15.000 euro zhdëmtim për ankuesin.

Në lëndën Kitanovski kundër Maqedonisë, bëhet fjalë për viktimë të torturës policore. Mbi viktimën është hapur zjarr pas të cili ai është rrahur brutalisht sepse ka refuzuar të ndalet gjatë kontrollit në qarkullim. Pas

dorëzimit të kallëzimit penal nga MPB-ja kundër Kitanovskit, ai është dënuar, por kallëzimi i tij penal kundër policëve nuk është procesuar fare nga Prokuroria Themelore Publike Shkup. Gjykata Evropiane ka nxjerrë përfundimin se prokuroria nuk i ka ndërmarrë të gjitha masat hetimore dhe nuk ka bërë asnjë përpjekje që ta pyesë ankuesin, policët apo cilindo person tjetër i cili mund të sigurojë informacione relevante në drejtim të zbardhjes së fakteve në këtë rast. Në këtë rast Maqedonia është dënuar me 10.000 euro zhdëmtim për ankuesin.

Në lëndën Ilievska kundër Maqedonisë, përsëri bëhet fjalë për viktimitë nga brutaliteti policor mbi znj. Ilievska gjatë dërgimit të saj nga Kriva Pallanka deri në Spitalin Psikiatrik në Bardovcë. Si dhe në rastet e mëparshme, ankuesja ka ngritur kallëzim penal kundër policëve, por ai është hedhur poshtë nga Prokuroria Themelore Publike në Kriva Pallankë, kështu që ankuesja ka dorëzuar padi private për të cilën gjykata ka vendosur se nuk ka pasur dëshmi të mjaftueshme kundër policëve. Në këtë rast Maqedonia është dënuar me 5.000 euro zhdëmtim për ankuesen.

Edhe pse këto evenimente kanë ndodhur midis vitit 2004 dhe 2009, Komiteti i Helsinkit në 3 vitet e fundit ka regjistruar një duzinë rastesh të ngjashme të cilat ngjasojnë me ngjarjet e përshkruara dhe për të cilat prokuroria nuk ka zbatuar hetim efektiv. Shembujt e tillë janë tortura mbi tre të paraburgosur nga Shqipëria të cilën janë lidhur me pranga për radiatorin,<sup>10</sup> i paraburgosuri i rrahut i cili është urdhëruar të zhvishet në tualetin e paraburgimit,<sup>11</sup> qytetari i sulmuar brutalisht nga policia në rrugë në Ohër,<sup>12</sup> personi i dënuar i cili pas sulmit nga polici i burgut humbi një veshkë dhe tëmthin,<sup>13</sup> sulmi i një numri të madh forcash policore mbi bashkësinë rome në lagjen Topaana,<sup>14</sup> rrahja e djaloshit të pafajshëm në Stacionin policor në Demir Hisar<sup>15</sup>, rrahja e të miturve romë nga Njësia policore “Alfa”,<sup>16</sup> lidhja me litar të të miturit Leo të vendosur gabimisht në spitalin psikiatrik,<sup>17</sup> përdorimi i ujit të ndotur në Burgun e Kumanovës<sup>18</sup> etj.

Komiteti i Helsinkit u është drejtuar me mesazh pushteteve që të zbatojnë politikë të tolerancës zero ndaj akteve të torturës nga personat zyrtarë. Pasiviteti i prokurorisë publike në rastet e torturës, sidomos kur kryhet nga nëpunësit e policisë rrit mosbesimin e qytetarëve ndaj sistemit gjyqësor dhe mosparaqitjen e veprave të tillë. Është koha për ballafaqim me fenomenin e mosdënimit dhe solidarizimin e Prokurorisë Publike dhe gjyqësorit me policinë. Fokusi kryesor duhet të jenë viktimat për të cilat shteti nuk siguron mbështetje përkatëse juridike, mjekësore, psikologjike dhe sociale. Për arritjen e këtij qëllimi, Komiteti apelon që të zbatohet urgjentisht Direktiva 2012/29 e BE-së për vendosjen e minimum standardeve për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave nga krimi.

## 6. GJYKATA E APELIT MANASTIR NË MBROJTJE TË KEQTRAJTIMIT POLICOR

Komiteti i Helsinkit, nga gushti i viti 2013, e ka ndjekur rastin e M.V. (viktimitë e dhunës dhe keqtrajtimit policor) kundër T.A. (nëpunës policor në SPB në Manastir). M.V. në qershor 2013 është thirrur nga nëpunësi policor i Stacionit policor në Demir Hisar në bisedë informative, pa i thënë se cili është shkaku për këtë thirrje. Sipas dëshmisë së M.V., menjëherë pas hyrjes në stacion, një nëpunës policor ka filluar t'i bërtasë dhe ta ofendojë, duke e akuzuar se ka vjedhur akumulatorë. Në hapësirë atëherë është futur T.A. i cili pa asnjë nevojë e ka goditur M.V. me gju në pjesën e brinjëve, pastaj e ka goditur në kokë dhe e ka shkelur nëpër trup.

<sup>10</sup> Komiteti i Helsinkit, Raporti tremujor (tetor - dhjetor 2012): <http://www.mhc.org.mk/reports/99>

<sup>11</sup> Komiteti i Helsinkit, Raporti mujor - maj 2013: <http://www.mhc.org.mk/reports/124>

<sup>12</sup> Komiteti i Helsinkit, Raporti tremujor (prill - qershor 2013): <http://www.mhc.org.mk/reports/145>

<sup>13</sup> Ibid

<sup>14</sup> Ibid

<sup>15</sup> Komiteti i Helsinkit, Raporti dymujor (korrik - gusht 2013): <http://www.mhc.org.mk/reports/149>

<sup>16</sup> Komiteti i Helsinkit, Raporti dymujor (prill - maj 2014): <http://www.mhc.org.mk/reports/219>

<sup>17</sup> Komiteti i Helsinkit, Raporti mujor - qershor 2014: <http://www.mhc.org.mk/reports/237>

<sup>18</sup> Komiteti i Helsinkit, 20 tetor 2014: <http://www.mhc.org.mk/announcements/254>

Pas këtij veprimi M.B. ka rënë në dysheme, kurse nëpunësi policor e ka ngritur dhe e ka çuar në një hapësirë tjetër ku gjendeshin të mitur. Fëmijët janë akuzuar për vjedhje akumulatorësh. T.A. ka filluar t'u kërcënohet dhe t'u ushtrojë presion që të pranojnë se edhe M.B. ka qenë me ta kur kanë vjedhur. Edhe përkrah presionit, fëmijët nuk e kanë vërtetuar këtë teori. Në fund, T.A. e ka informuar M.B. se kamioni i tij është kontrolluar, se në të nuk ka akumulator të vjedhur dhe e ka liruar. M.V. së bashku me të jatin kanë shkuar në spital në Demir Hisar prej të cilit është dërguar në njësinë kirurgjike të ISHP në Manastir. Për shkak të dhimbjeve dhe lëndimeve, M.V. është mbajtur në mjekim dyditor. Për këtë rast M.V. posedon dëshmi mjekësore, gjetje mjekësore dhe ekspertizë gjyqësore-psikiatrike për dëm jomaterial.

Përfaqësuesi juridik i M.V. ka dorëzuar padi penale private në Gjykatën Themelore në Manastir për veprën penale "lëndim trupor", pas së cilës gjykata ka filluar procedurën e cila është mbikëqyrur tërësisht nga Komiteti i Helsinkit. Sipas neni 49, paragrafi 3 i Ligjit për Procedurë Penale (LPP, Gazeta Zyrtare e RM-së, 15/2005) teksti i përditësuar, Gjykata Themelore duhej të përcaktonte se vepra e paraqitur ("Keqtrajtim dhe lloj tjetër i veprimit të ashpër, çnjerëzor dhe ofendues" nga neni 142 i Kodit Penal) ndiqet me obligim zyrtar, kurse jo me padi private dhe padia të dërgohet në Prokurorinë Themelore Publike Manastir. Kjo gjë nuk ndodhi, kështu që gjykimi është mbajtur në kundërshtim me LPP.

Gjatë vitit 2014, Gjykata Themelore mori Vendimin K-432/13 me të cilin nëpunësi policor është shpallur fajtor dhe është shqiptuar dëmi me kusht me afat prej 30 ditësh, me kontroll deri në 1 vit. Duke vepruar sipas ankesës së nëpunësit policor të akuzuar, Gjykata e Apelit Manastir me Vendimin KZh - 684/14 e ka shfuqizuar vendimin e Gjykatës Themelore dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim. Sipas Gjykatës së Apelit, nuk ka qenë e qartë si kanë ndodhur lëndimet trupore te viktima. Pas rigjykimit, duke i marrë parasysh udhëzimet e Gjykatës së Apelit, Gjykata Themelore ka marrë Vendimin K-564/14 me të cilin i akuzuari është liruar nga akuza. Pas ankesës së viktimës, Gjykata e Apelit, në nëntor të vitit 2015 nëpërmjet Vendimit KZh- 277/15, e ka vërtetuar vendimin për lirim të Gjykatës Themelore.

Pas mbikëqyrjes së të gjitha seancave gjyqësore dhe shqyrtimit të raporteve të lëndës, Komiteti i Helsinkit shpreh keqardhjen dhe shqetësim për procedurat e Gjykatës Themelore Manastir e cila nuk duhej të vepronte sipas padisë private. Lënda duhej dërguar për hetim në Prokurorinë Themelore Publike. Shqetëson sidomos raporti i Gjykatës së Apelit e cila nëpërmjet udhëzimeve të veta për Gjykatën Themelore vihet në mbrojtje të brutalitetit dhe vullnetit policor. Për këto arsye, Komiteti i Helsinkit viktimën e përfaqëson para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## 7. PLUMBAT PREJ GOME I RREZIKOJNË TË DREJTAT E QYTETARËVE

Më 02.03.2015, Kuvendi i RM-së me 59 vota pro dhe tri vota kundër e votoi Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për policinë, me të cilin policia ka marrë bazë ligjore të përdorë mjete të reja për presion gjatë shpërndarjes së protestave të dhunshme. Midis mjeteve të reja për presion janë shkopinj të elektronikë paralizues, plumbat prej gome dhe mjetet piroteknike-shpërthyes (neni 91, paragrafi 2, pika 3, 5, dhe 8). Ligji i ri, parashikon edhe një nen të ri, 91-a ku janë kushtet e përcaktuara për përdorim të mjeteve të reja për presion kundër grupit. Kështu, parashikohet që paralizuesi elektronik të përdoret për ballafaqim momental, paaftësim të përkohshëm dhe ndërjegjësim të personave agresivë, kur me mjete të tjera personi nuk mund të ndërjegjësohet; plumbi prej gome të përdoret për paaftësim të përkohshëm të personave në turmë e cila e thyen aktivisht rendin dhe qetësinë publike; kurse mjetet piroteknike-shpërthyes janë bomba flesh, shok dhe tymuese të cilat përdoren për vendosjen e rendit dhe paqes së prishur publike, marrjen e personave nga hapësira të mbyllura, tërheqjen e vëmendjes apo zgjidhjen e situatave me pengjet.

Megjithatë, këto dispozita janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe përbëjnë rrezik të madh për jetën dhe shëndetin e njerëzve mbi të cilët zbatohen dhe janë tërësisht të panevojshme gjatë zbatimit të ligjeve në Republikën e Maqedonisë.

Në ballafaqimin me kryerësit e rrezikshëm të veprave penale, te policët në Evropë mund të vihet tendenca në rritje e zbatimit të të a.q. armë jovdekjeprurëse, midis të cilave janë edhe mjetet e reja për presion të parapara në Ligjin për polici. Por, për dallimi qëndron në përcaktimin kur, përkatësisht nën cilat kushte, nëpunësi policor mund t'i përdorë këto mjete dhe cila është procedura e saktë, përkatësisht procedura për zbatimin e tyre.

Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës dhe Sjelljes Çnjerëzore apo Ofenduese dhe Dënimit (KPT) në Standardet<sup>19</sup> e veta thotë qartë se zbatimi i Armëve me Zbrazje Elektrike (AZE) mund të ndodhë vetëm kur ekziston “kërcënim i drejtpërdrejtë ndaj jetës apo rrezik prej lëndimit serioz”. Mandej KPT vazhdon me qëndrimin se “zbatimi i këtyre armëve me qëllim të vetëm sigurim i respektimit të rendit nuk lejohet”. Neni i ri 91-a përcakton se paralizuesi elektrik do të zbatohet kur me mjete të tjera personi nuk mund të ndërjegjësohet, por nuk parashikon njëkohësisht se duhet të ekzistojë rrezik i drejtpërdrejtë për jetën e ndonjë personi apo rrezik i drejtpërdrejtë për lëndim trupor. Ligjvënësi ynë e ka zvogëluar joligjërish pragun e kushteve të nevojshme për zbatim të këtij mjeti në agresivitet të thjeshtë tek personi kundër të cilit do të përdoret. Kjo dispozitë e përgjithshme në praktikë do të ketë interpretim mjaft subjektiv dhe të gjerë në lidhje me faktin se cila sjellje e personave mund të konsiderohet si agresive, ndërsa cila sipas ligjit mund, por nuk duhet të jetë me patjetër kërcënim i drejtpërdrejtë për jetën apo rrezik për lëndim serioz. Në fund edhe vetë KPT-ja nxjerr përfundim se zbatimi i këtyre mjeteve ndiqet detyrimisht me rrezikun e theksuar për shëndetin e personit mbi të cilin zbatohen dhe nëpunësi policor i cili i përdor duhet të jetë i trajnuar edhe për të dhënë ndihmën e parë gjatë ndodhjes së efekteve të padëshirueshme. Përsëri, përcaktimi i paqartë i kushteve kur mund të zbatohet ky mjet, sjell rrezik të papranueshëm për jetën dhe shëndetin e qytetarëve dhe rrezik praktik dhe real se gjatë prishjes së rendit dhe paqes publike në pjesën më të madhe, nëpunësi policor i cili përdor paralizues elektrik ndaj një grupi personash, nuk mund të reagojë në kohë nëse shkakton rrezik për jetën dhe shëndetin e personit të targetuar.

Plumbat prej gome janë, gjithashtu, mjete mjaft kontroverse për presion gjatë mbajtjes së rendit dhe paqes publike. Në vendimin e vet në rastin Kiorkan dhe të tjerët kundër Rumanisë (Aplikimi nr. 29414/09 dhe 44841/09), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut shprehet qartë se plumbat prej gome mund të zbatohen vetëm kur përdorimi i tyre është “absolutisht i domosdoshëm” në kuptimin e nenit 2 paragrafit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht në situata kur lejohet aksioni ligjor kundër jetës njerëzore. Edhe pse armët e zjarrit mund të zbatohen gjatë aksioneve ligjore për qetësim të rebelimeve apo trazirave, megjithatë shkelja aktive e rendit dhe paqes publike, që në përputhje me nenin e ri 91-a është kushti i vetëm për zbatimin e këtij mjeti, nuk i përmbush standardet për zbatim të armëve të zjarrit. Hulumtimet dëshmojnë se problemi me plumbat prej gome qëndron në faktin se ata mund të jenë vdekjeprurës nëse përdoren në një largësi të vogël si edhe se mund të shkaktojnë lëndime serioze gjatë goditjes edhe në një largësi më të madhe, kurse ekziston edhe rrezik serioz prej rikoshetës, që i bën shumë të pasaktë gjatë përdorimit.

Gjatë kësaj duhet të përmendet se bëhet fjalë për moment simptomatik ku pushteti ligjvënës vendosi që ta zgjerojë në këtë mënyrë spektrin e mjeteve për presion që mund të zbatohen kundër një grupi. Siç thotë edhe vetë KPT-ja, vendimi i dhënies forcave shtetërore autorizim për zbatimin e këtyre armëve duhet të jetë rezultat i një debati të thelluar në shtet në nivel ligjvënës dhe ekzekutiv. Në Republikën e Maqedonisë, debati i tillë ka

<sup>19</sup> CPT/Inf/E(2002)1 - Rev. 2015

munguar. Leximi në Kuvend i këtyre ndryshimeve ligjore me të cilat hyhet seriozisht dhe drejtpërdrejt në të drejtën e jetës së qytetarit kaloi pa debat të gjerë shoqëror, pa prezantim të hulumtimeve relevante dhe në kushte kur deputetët e opozitës janë jashtë Parlamentit. Mandej, këto ndryshime janë miratuar në kushte të një numri të madh tubimesh publike paqësore dhe të padhunshme të qytetarëve deri tani. Rastet e izoluar të prishjes së rendit dhe paqes publike në masë më të madhe, që ndodhën në disa protesta të dhunshme në vitin 2014 janë të pamjaftueshme për arsyetimin e zgjerimit të mjeteve për presion kundër një grupi personash. Mandej, në ligj është përcaktuar se aktet nënligjore duhet të miratohen në afat prej gjashtë muajsh, por ky afat ligjor nuk është respektuar dhe aktet e tilla nuk janë miratuar ende. kjo do të thotë se ekziston mundësi ligjore e cila lejon zbatim të mjeteve të reja, pa u rregulluar detajisht ai zbatim, që zmadhon manifestimin dhe zbatimin e vlerësuar subjektivisht të fuqisë nga policia dhe pushteti, që rezulton me zmadhimin e frikës së qytetarëve prej policisë.

## 8. INSTITUCIONET PSIKIATRIKE

Gjatë muajit tetor të vitit 2015, përfaqësues të Komitetit të Helsinkit kanë vizituar dy institucione psikiatrike, ISHP Spitalin Psikiatrik "Shkup" në Bardovci dhe ISHP Spitalin Psikiatrik Demir Hisar. Vizita në të gjitha institucionet e llojit të tillë vazhdojnë të zbatohen edhe gjatë vitit 2016.

Spitali psikiatrik "Shkup" është institucioni më i madh i këtij lloji, kapaciteti i të cilit është rreth 1000 shtretër, kurse numri i personelit është 353 persona të punësuar. Gjatë vizitës është vërtetuar se, ekziston një përparim i lehtë në kushtet e institucionit, megjithatë janë vërejtur një numër i madh mangësish. Me përjashtim të pavijoneve të rinovuara (njësia akute dhe "hosteli"), kushtet për jetë në pjesët e tjera janë substandarde. Higjiena personale e pacientëve është e keqe dhe për pjesën më të madhe të tyre fitohet pamja se janë tërësisht të braktisur. Në spital ka mungesë serioze të programeve rehabilitim dhe ka një numër të vogël aktiviteteesh ku janë përfshirë pacientët, si punë në kuzhinë, aktivitetet figurative dhe muzikore ose përpunimi i objekteve. Në pjesën më të madhe pacientët ditët i kalojnë duke parë televizor dhe duke fjetur, që ndikon negativisht në gjendjen e tyre shëndetësore.

Në institucionin psikiatrik në Demir Hisar, edhe pse në momentin e vizitës kapaciteti ishte plotësuar rreth 80%, megjithatë në shumicën e pjesëve vihet re mbingarkesë dhe kryesisht nuk ka kushte për respektimin e privatësisë së pacientëve. Në përgjithësi, kushtet për jetë janë në standardet e përcaktuara, ka igrasi, kurse higjiena nuk është në nivelin e duhur. Institucioni është i llojit të mbyllur, prandaj të gjitha repartet janë vazhdimisht të mbyllura. Në këtë spital mjekohen edhe të mitur, përkatësisht persona nga 16 deri në 18 vjet të cilët nuk janë vendosur në repart më vete, por janë së bashku me pacientët e rritur. Pjesa më e madhe e pacientëve janë përfshirë në aktivitete, të cilat përfshijnë aktivitete fizike, terapi artistike, individuale dhe në grup. Megjithatë, vihet re se personeli i trajton pacientët si të jetë tërësisht të paaftë që ndikon negativisht mbi përparimin e tyre.

Në të dy institucionet vihen re dy probleme të përbashkëta. I pari është mosrespektimi i afateve për mbajtje të detyrueshme në institucion për të cilën nga momenti i vendosjes së detyrueshme në institucion, gjykata duhet të marrë vendim në afat prej 48 orësh. Në vend të afatit të paraparë gjykatës i nevojiten më tepër se 4 ditë që të japë vendimin. Në mungesë të vendimit nga gjykata, personave të cilët janë sjellë me forcë në kundërshtim me ligjin, u kufizohet liria, kurse njëkohësisht u rrezikohet edhe integriteti fizik dhe shëndeti mental. Sipas kësaj, Komiteti i Helsinkit rekomandon se është e domosdoshme të respektohen dispozitat ligjore dhe afatet për hospitalizim të vullnetshëm dhe të detyrueshëm.

Problemi i dytë i cili është vënë re, lidhet me zbatimin e masës për mbrojtje nga dhuna familjare. Sipas Ligjit për Parandalim, Mbrojtje dhe Pengim të Dhunës Familjare, ushtruesit e dhunës familjare vendosen në institucione psikiatrike nën masën “mjekim i obligueshëm nëse keqpërdoret alkooli, droga dhe substancat e tjera psikotrope ose ka sëmurje psikike”<sup>20</sup>. Megjithatë, nga vizitat e realizuara janë konstatuar se disa persona të cilët janë në këtë institucion, nuk janë të varur nga alkooli apo droga, dhe as nuk kanë sëmundje psikike. Në një rast të veçantë, masa është shqiptuar nga gjykatësi pa e parë personin. Komiteti i Helsinkit konsideron se vendosja e ushtruesve të dhunës familjare në këtë lloj institucionesh përbën shkelje të rëndë të të drejtave të tyre, kurse njëkohësisht ka edhe pasoja mjaft të dëmshme mbi shëndetin e tyre. Prandaj, Komiteti i Helsinkit apelon në një kohë sa më të shkurtër të bëhen ndryshime në Ligjin për Parandalim, Mbrojtje dhe Pengim të Dhunës Familjare dhe në asnjë rast gjykata të mos e shqiptojë masën, pa e parë gjykatësi paraprakisht personin ose të marrë mendim nga institucioni shëndetësor.

---

<sup>20</sup> Ligji për Parandalim, Mbrojtje dhe Pengim të Dhunës Familjare, neni 35 pika 9, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.138 më 17.09.2014, që zbatohet nga 01.01.2015

## VI. DISKRIMINIMI

### 1. HYRJA

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut e ka ndjekur aktivisht gjendjen me diskriminimin e romëve në Republikën e Maqedonisë gjatë vitit 2015 nëpërmjet monitorimit të procedurave gjyqësore të ngritura për mosdiskriminim, nëpërmjet ankesave të marra nga qytetarët – viktimat të diskriminimit dhe nëpërmjet para organeve për barazi dhe para gjykatave. Mandej, Komiteti i Helsinkit, së bashki me anëtarët e tjerë të Rrjetit për Mbrojtje nga Diskriminimi ka dorëzuar Raportin në hije mbi diskriminimin e romëve te Komiteti për Eliminim të të gjitha formave të diskriminimit rasor, pjesë e Kombeve të Bashkuara, i cili ka vërtetuar shkeljen e të drejtave të romëve dhe diskriminim në shumë fusha dhe dha rekomandim për tejkalimin e tyre.

Në bazë të të gjitha informacioneve nga institucionet kompetente për mbrojtjen e qytetarëve nga diskriminimi dhe rastet të cilat janë paraqitur në Komitet, mund të konstatohet se dhe pse kanë kaluar pesë vjet nga zbatimi i Ligjit për Ndalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi dhe formimi i Komitetit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nuk mund të flitet ende për mbrojtje efektive në pjesën e diskriminimit, sidomos kur bëhet fjalë për grupet e marginalizuara. Pikat kryesore të cilat lidhen me qasjen te drejtësia e viktimave të diskriminimit, përkatësisht çlirimi nga shpenzimet gjyqësore për ngritjen e procedurës gjyqësore për mbrojtjen e diskriminimit, pavarësi të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe përfshirja e orientimit seksual dhe identiteti gjinor si baza për diskriminim, kanë mbetur të pandryshuara.

Nga fundi i vitit 2015 ka filluar procedura për zgjedhje të anëtarëve të rinj të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi, e cila dha mundësi për ndryshime thelbësore në përbërjen e Komisionit dhe përfshirjen e ekspertëve të dëshmuar nga fusha e mosdiskriminimit. Megjithatë, Kuvendi vendosi të zgjedhë anëtarë të cilët në pjesën më të madhe nuk kanë përvojë paraprake në fushën dhe punën me grupe të lëndueshme, kurse një pjesë e tyre lidhen me koalicionin qeveritar ose janë mbështetës publikë të politikave të pushtetit, sidomos ndaj politikave të cilat nuk mundësojnë trajtim të barabartë të pakicave etnike në shtet. Me përzgjedhjen e kryer është e qartë tendenca për një partizim edhe më të madh të këtij trupi, i cili sipas standardeve ndërkombëtare dhe vendase duhet të jetë i pavarur. Mandej, konsiderojmë se vetë përbërja e Komisionit nuk është shpirtin e respektimit të dallimeve, sidomos, sepse ka anëtare vetëm një grua dhe nuk janë përfshirë bashkësitë më të vogla etnike.

Njohuritë se mbrojtja gjyqësore në rastin e diskriminimit ka filluar të shfrytëzohet gjithnjë dhe më tepër, janë indikator për vetëdijen e zmadhuar të qytetarëve mbi mundësitë për mbrojtje gjyqësore në rastet e diskriminimit. Megjithatë, pjesa më e madhe e procedurave të ngritura gjyqësore janë mbështetur nga



qytetarë të cilët sigurojnë ndihmë juridike në rast të diskriminimit, sepse Ligji për Ndalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi nuk mundëson çlirim prej shpenzimeve gjatë ngritjes së procedurës. Për këto arsye mund të konstatohet se qasja të drejtësia për mbrojtje gjyqësore nga diskriminimi mbetet e kufizuar.

Duke vepruar sipas ankesave të dorëzuara nga qytetarët dhe duke e ndjekur gjendjen në shoqëri dhe në media, Komiteti i Helsinkit ka përcaktuar se pjesa më e madhe ka të bëjë me diskriminimin në bazë etnike, përkatësi politike, orientimi seksual, identitet gjinor, gjini dhe seks, kurse më të pasqyruar ndaj diskriminimit janë romët. Ky konstatim rrjedh nga diskriminimi sistematik që vazhdon të kryhet mbi përfaqësuesit e bashkësisë rome me kufizim të të drejtës së largimit të lirë nga shteti nga Ministria e Punëve të Brendshme, por edhe nga ndarja që ekziston ndaj fëmijëve romë në arsim. Gjendja e tillë është përcaktuar edhe nga Komiteti për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor i Kombeve të Bashkuara i cili tha se kufizimi i lirive dhe të drejtave themelore dhe mbrojtja e tyre joefikase, sidomos në pjesën e lëvizjes së lirë të romëve, mungesës së dokumenteve personale, situatës së fëmijëve romë në rrugë dhe në pjesën e segregimit në arsim. Sipas shqyrtimeve përfundimtare të Komitetit për Eliminim të Diskriminimit Racor të Kombeve të Bashkuara është e dukshme se shteti nuk arriti ta përmirësojë gjendjen e romëve si përfaqësues të bashkësive etnike më të marginalizuara në Republikën e Maqedonisë. Komiteti shprehu shqetësim edhe për problemin e strehimit të romëve dhe për statusin e keq social, duke konstatuar se bashkësia etnike rome është më e reflektuar ndaj varfërisë, papunësisë dhe përjashtimit social. Si rrjedhim nga e gjithë kjo kërkohet që Qeveria të Republikës së Maqedonisë ta respektojë Konventën për Eliminim të të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe të ndërmarrë masa urgjente për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit për Eliminim të Diskriminimit Racor.

Në pjesën e diskriminimit në bazë të përkatësisë politike në Komitet janë paraqitur raste të diskriminimit në pjesën e punësimit, kurse të cilat lidhen me papunësimin e punëtorëve mjekësorë dhe doktorëve për shkak të përkatësisë së tyre partiake në koalicionin qeveritar. Këto raste e vërtetuan praktikën e deritanishme të papunësimin të personave të cilat nuk janë përfaqësues partiakë të koalicionit qeveritar, që është problem sistematik në shoqërinë tonë.

Njerëzit LGBTB edhe mandej mbetet lëndë e diskriminimit sistematik, për shkak të mosveprimit të prokurorisë publike pas sulmeve të shumëfishta të LGBTB-Qendrës dhe mospërfshirjen e orientimit seksual dhe identitetit gjinor në një numër të madh ligjesh me të cilat duhet të sigurohet mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe inkluzioni në shoqëri.

## 2. PROFILIZIMI RACOR NË KALIMET KUFITARE DHE KUFIZIMI I TË DREJTËS SË LËVIZJES SË LIRË

Gjatë vitit 2015 në Komitetin e Helsinkit janë paraqitur 2 raste të reja të diskriminimit të romëve në kalimet kufitare për të cilat Komiteti i Helsinkit siguroi mbrojtje gjyqësore. Rasti i parë lidhet me ndalimin e pabazuar të familjeve rome që të largohen nga shteti dhe të udhëtojnë në Gjermani nga nëpunës policorë të aerodromit Aleksandri i Madh, kurse në rastin e dytë bëhet fjalë për person i cili është ndaluar të largohet nga shteti dhe të udhëtojë në Itali nga nëpunësit policorë në kalimin kufitar Tabanovcë.

## 3. DISKRIMINIMI NGA KOPSHTET PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUAR INTELEKTUALE

Me kërkesë për ndihmë juridike për mbrojtjen nga diskriminimi në Komitetin e Helsinkit u drejtua prindi i një fëmije 4-vjeçar me aftësi të kufizuara intelektuale, për shkak të mosqasjes të arsimit parashkollor – kopsht. Në rastin konkret bëhet fjalë për fëmijë hiperaktiv me aftësi intelektuale pak të kufizuara dhe probleme me të

folurin. Sipas mendimit të Entit për Shëndetin Mendor – Shkup duhet të përfshihet në trajtim në logoped dhe defektolog dhe duhet të përfshihet në moshën parashkollore.

Deri në prill 2015 fëmija është përfshirë në kopsht, por për shkak të presioneve nga të punësuarit, kujdesi jopërkatës dhe mungesa e kapacitetit njerëzor për punë me fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale, prindërit janë obliguar ta çregjistrojnë nga kopshti, me qëllim që të gjejnë kopsht (privat ose publik) i cili ka kapacitetet hapësinore dhe njerëzore për kujdes për fëmijë me aftësi pak të kufizuara intelektuale. Nga ky moment prindërit kanë bërë përpjekje ta përfshijnë fëmijën si në kopsht publik ashtu edhe në privat, por të gjitha përpjekjet janë të pasuksesshme.

Kjo është mungesë sistematike e cila reflektohet sidomos mbi fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale dhe e kufizon ose mund ta kufizojë të drejtën e qasjes në kopshte. Problemi del nga fakti se në nenin 64 të Ligjit për Mbrojtje të Fëmijëve është paraparë se në grupet e rregullta mund të përfshihet një fëmijë me pengesa të lehtë në zhvillimin mental apo kufizime fizike, ndërsa në rast të tillë numri i fëmijëve në grupe zvogëlohet me dy fëmijë. Mandej, kjo dispozitë respektohet rrallë, sepse numri më i madh i kopshteve, sidomos në komunat e qytetit të Kopshtit, përfshijnë një numër më të madh të fëmijëve në grupe sesa numri i standardeve të parashikuara, me qëllim që sa më shumë fëmijë të përfshihen në procesin edukues në kopshte. Nga kjo del përfundimi se kapacitetet e dobëta njerëzore dhe hapësinore të kopshteve ndikojnë mbi qasjen te kopshtet të fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale, të cilët kanë nevoja të ndryshme prej fëmijëve të cilët nuk kanë aftësi të kufizuara.

Konsiderojmë se ky problem sistematik ndikon në trajtimin e pabarabartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale në krahasim me fëmijët të cilët nuk kanë aftësi të kufizuara në qasjen te kopshtet. Për këto arsye, Komiteti i Helsinkit në dy vitet e kaluara ka punuar sidomos në qasjen në kopshte të fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale. Komiteti ka zbatuar testime të situatës nëpërmjet telefonatave me të cilët është hulumtuar diskriminimi potencial i kopshteve ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale. Një nga qëllimet e testimit ishte të përcaktohen se a ndikojnë kapacitetet e dobëta njerëzore dhe hapësinore të kopshteve mbi qasjen në kopshte të fëmijëve me aftësi të kufizuara intelektuale. Janë testuar 70 kopshte në nivel të të gjithë shtetit, prej të cilave 56 kopshte shtetërore dhe 14 kopshte private. Në bazë të të gjitha të dhënave të mbledhura mund të konstatohet se në kopshte nuk ekzistojnë as kapacitete hapësinore as njerëzore për pranim dhe edukim të të gjithë fëmijëve të moshës parashkollore të cilët kanë nevojë për t'u regjistruar në kopshte. Mandej, në këtë hulumtim janë përcaktuar edhe disa raste ku ekziston dyshim i bazuar se kryhet diskriminim i drejtpërdrejtë ndaj fëmijëve me aftësi pak të kufizuara intelektuale, prandaj Komiteti i Helsinkit më 15.12.2015 ka dorëzuar ankesë në Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi, për të cilën nuk kemi marrë ende përgjigje.

#### 4. DISKRIMINIMI NË BAZË TË PËRKATËSISË PARTIAKE

Pas përfundimit të zgjedhjeve lokale në vitin 2013 në Gostivar dhe pas ndryshimit të pushtetit lokal, janë paraqitur një numër i madh rastesh të diskriminimit në bazë të përkatësisë politike, duke përfshirë edhe NP Komuna. Domethënë, pas ndryshimit të drejtorit të NP Komuna Gostivar, udhëheqësit e sektorëve të veçantë janë shkarkuar menjëherë nga u.d. drejtori i ri. Për këtë rast është ngritur edhe procedurë gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi i cili është i plotfuqishëm, kurse vendimi është negativ. Për këtë është dërguar kërkesë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave në Gjykatën Kushtetuese e cila vendosi të mbajë debat publik pas kalimit të mbi 6 muajve, që është në kundërshtim me parimin e efikasiteti i cili duhet të respektohet sidomos në rastin e kërkesave për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve. Veprimi i tillë i Gjykatës Kushtetues e vërteton përsëri mungesën e efikasitetit të saj në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

## VII. GJUHA E URREJTJES DHE VEPRA NGA URREJTJA

### 1. GJUHA E URREJTJES

Gjatë vitit, Komiteti i Helsinkit e monitoroi dhe e dokumentoi gjendjen edhe me fjalën e urrejtjes në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Monitorimi u realizua nëpërmjet disa metodave, respektivisht, nëpërmjet ngjarjeve të paraqitura në platformën [www.govornaomraza.mk](http://www.govornaomraza.mk) e instaluar gjatë vitit 2014, nëpërmjet monitorimit të përditshëm të rrjeteve sociale, portaleve të internetit dhe hapësirës tjetër publike, si dhe nëpërmjet të dhënave statistikore të organeve kompetente shtetërore për ndjekjen dhe ballafaqimin me gjuhën e urrejtjes.

Gjatë vitit 2015 në platformën [www.govornaomraza.mk](http://www.govornaomraza.mk), u paraqitën 33 raste të gjuhës së urrejtjes prej të cilave 26 ishin verifikuar, ndërsa 7 nuk ishin verifikuar për shkak të informatave të paplota. Si shkaqe më të përhapura në lidhje me rastet e paraqitura të gjuhës së urrejtjes janë orientimi seksual dhe identiteti gjinor, përkatësia etnike dhe fetare zënë vendin e dytë, ndërsa përkatësia politike paraqitet si shkak i tretë më i përhapur për gjuhën e urrejtjes. Nga rastet e paraqitura vërehet se gjuha e urrejtjes është më e përhapur në rrjetet sociale, por nuk ngelin prapa edhe portalet në internet, respektivisht mediat në internet. Shqetëson fakti që gjuha e urrejtjes është gjithnjë e më e pranishme në shkrimet dhe tekstet e mediave në internet me çka cenohen standardet etike dhe parimet e gazetarisë, për të cilën flasin edhe vendimet e shumta të Këshillit për Etikë në Media.<sup>21</sup>

Gjatë muajit janar, u vërejt gjuhë e urrejtjes me përmbajtje naziste me vizatimin e kryqit të thyer (svastika) në përmendoren në qendër të qytetit Shkup, respektivisht në oborrin e shkollës së mesme. U deshën disa ditë para se të vërehet dhe denoncohet, ndërsa disa ditë më vonë u ndërmorën aktivitete nga institucionet kompetente dhe hapa për mënjanimin e vizatimeve. Gjatë muajit mars, prill dhe maj, u vërejtën kërcënime dhe thirrje për dhunë nga persona publikë, mbështetës të politikave qeveritare ndaj jomendimtarëve të njëjtë me qeverinë. Kriza politike (keqpërdorimi i pushtetit, prezantimi i bisedave të përgjuara në publik) dhe ngjarje të shumta shoqërore dhe politike (protesta, marshe) gjatë vitit kontribuuan dukshëm për përhapjen e urrejtjes në bazë të përkatësisë politike. Kremtimi i Javës së Krenarisë dhe ngjarjet individuale gjatë asaj jave, ishin cak i shprehjeve homofobike, kërcënimeve dhe thirrjeve për dhunë nga individë dhe grupe në rrjetet sociale gjatë muajit qershor. Duke marrë parasysh rastet e shumta të gjuhës së urrejtjes dhe dhunës fizike ndaj bashkësisë LGBTI gjatë viteve të kaluara, kjo dukuri nuk na befasoi. Njëri prej rasteve më të rëndësishme u vërejt gjatë muajit nëntor, kur në rrjetin social Fejsbuk u vërejt shpërhapja e afishes e cila përmban gjuhë të urrejtjes në bazë të përkatësisë fetare dhe bindjes fetare. Respektivisht, në këtë afishe bëhet thirrje për “protestë kundër islamizimit të Kriva Pallankës”. Përveç tekstit i cili sqaron kur dhe ku do të mbahet protesta, në afishe gjendet edhe fotografi me pesë objekte të fesë islame - xhami, të shkarravitura. Protesta ishte si pasojë e fjalimit të

<sup>21</sup> Vendime dhe mendime të Komisionit për Ankesa pranë Këshillit për Etikë në Mediat në Maqedoni <http://semm.mk/komisija-za-albi/odluki-i-mislenja>

kryetarit të komunës, i cili në konferencë për shtyp në lidhje me ndërtimin e kishës në qendër të qytetit, në mënyrë eksplicite konstatoi se përderisa ai është në funksionin kryetar komune, në qytet do të ndërtohen vetëm objekte të fesë ortodokse. Të nxitur nga kjo, qytetarët kanë filluar iniciativë për grumbullimin e nënshkrimeve kundër ndërtimit të xhamisë në qytet, që më vonë të organizohet edhe protestë. Protesta e paralajmëruar në të cilën morën pjesë rreth 1200 njerëz, u mbajt në rregull, me përjashtim të disa brohoritjeve të cilat përmbajnë gjuhë të urrejtjes, por shpejt u ndaluan nga organizatorët. Mirëpo, më vonë natën, persona të pidentifikuar e demoluan objektin, faltoren e komunitetit fetar mysliman. Ngjarja u paraqit në polici, e cila bëri inspektim në vendin e ngjarjes dhe ndërmori masa për zbardhjen e rastit. Nga Komiteti i Helsinkit, ngjarja u përkufizua si vepër e urrejtjes, që i konfirmon edhe më tepër pasojat e rrezikshme dhe të dëmshme nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes në vende publike. Shpërndarja e afishes me gjuhë të urrejtjes, në njoftimin e disa organizatave joqeveritare (Platforma kundër Gjuhës së Urrejtjes) ishte dënuar ashpër, ndërsa paraqitën edhe fletkallëzim të Ministrisë së Punëve të Brendshme - Njësia për krim elektronik, për përhapjen e gjuhës së urrejtjes në mënyrë elektronike. Pas një periudhe të shkurtë afishen e hoqën nga rrjetet sociale.

Komiteti i Helsinkit, vërejti prezencë të zmadhuar të gjuhës së urrejtjes në vende publike dhe shpreh shqetësim për përdorimin e gjuhës së urrejtjes nga persona publikë. Gjendja e konstatuar, paraqitet si pasojë e drejtpërdrejtë e qeverisjes dhjetëvjeçare, konservatore, e cila në mënyrë intensive i promovon vlerat tradicionale dhe fetare si bazë të shoqërisë, e thekson rëndësinë e popullit maqedonas në mjedis multietnik dhe në mënyrë indirekte e vendos përcaktimin politik (partiak) si karakteristikë të pandashme të individit dhe kusht të patjetërsueshëm në jetën shoqërore.

Edhe përkrah përfaqësimit gjithnjë e më të madh të gjuhës së urrejtjes në jetën publike dhe në përditshmëri, vërehet numër relativisht i vogël i ngjarjeve të denoncuara për përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Mosdenoncimi i rasteve mund të sqarohet si pasojë e dy faktorëve. I pari është mos identifikimi i gjuhës së urrejtjes dhe elementët e saj kryesorë, si dhe mos përkufizimi i plotë i bazave të gjuhës së urrejtjes nga qytetarët. Paralelisht me këtë sugjerohet edhe mosinformimi i qytetarëve me kompetencat e institucioneve dhe obligimet për veprim në raste të gjuhës së urrejtjes. Faktori i dytë shumë më i rëndësishëm, është numri i vogël i rasteve të akuzave të ngritura për përdorimin e fjalës së urrejtjes nga prokuroria publike dhe numri i vogël pothuajse nuk ekziston, i personave të dënuar ose të gjobitur të cilët kanë përdorur gjuhë të urrejtjes. Përkatesisht, gjatë vitit, nga 21 gjykata themelore prej të cilave Komiteti i Helsinkit mori përgjigje, procedohet vetëm një procedurë në Gjykatën Themelore Shkup 1, për veprën nga neni 417 i Kodit Penal (Diskriminim në bazë racore dhe baza të tjera) në të cilën ka element të gjuhës së urrejtjes.<sup>22</sup> Kjo shifër dëshpëruese i çinkurajon viktimat nga gjuha e urrejtjes të denoncojnë rastet tek institucionet kompetente, ndërsa akoma më tepër i shkatërron të gjitha pritjet e mundshme për mbrojtje përkatëse gjyqësore gjatë shkeljes së rregullave të tyre.

Komiteti i Helsinkit, apelon për hapa urgjentë dhe seriozë në drejtim të ndryshimit të gjendjes së tillë. Për realizimin e këtij qëllimi, prokuroria publike dhe gjykatat duhet të tregojnë tolerancën zero ndaj personave të cilët përdorin gjuhë të urrejtjes dhe në mënyrë përkatëse t'i ndjekin dhe të dënojnë rastet në kuadër të kompetencave të tyre. Personat publikë dhe përfaqësuesit e lartë politikë, duhet të përmbahen nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe të dënojnë përdorimin e saj gjatë çdo rasti që u jepet. Detyrimisht duhet të respektohen edhe standardet profesionale në gazetari, që do të pamundësojë përdorimin e gjuhës së urrejtjes në hapësirat e mediave.

<sup>22</sup> Komiteti i Helsinkit dërgoi Kërkesa për qasje tek informatat me karakter publik të të gjitha 27 gjykatat themelore në Republikën e Maqedonisë, ndërsa përgjigje mori nga 21 prej tyre. Gjatë vitit 2015, vetëm një procedurë penale procedohet në Gjykatën Themelore Shkup 1 në bazë të nenit 417 të Kodit Penal, për të cilën ende nuk ka vendim të plotfuqishëm.

## 2. VEPRA NGA URREJTJA

Gjatë periudhës prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2015, Komiteti i Helsinkit, regjistroi gjithsej 44 vepra të kryera nga urrejtja. Pjesa më e madhe e incidenteve janë regjistruar sapo janë denoncuar nga mediat ose sapo janë publikuar nga Ministria e Punëve të Brendshme ndërsa për 4 (katër) incidente është raportuar nga mbikëqyrësit e Komitetit të Helsinkit. 31 prej incidenteve ishin verifikuar nëpërmjet shkresave për MPB, buletini ditor i MBP-së, njoftime për mediat dhe takim me viktimat e veprave të këtilla. 13 prej incidenteve të regjistruara nuk ishin verifikuar, nuk ishin vërtetuar, ishin dokumentuar për shkak të ekzistimit të mbajtjes së anës, përfshirë: Perceptimi i viktimës/dëshmitarit, komentet në vendin e ngjarjes, dallimi ndërmjet viktimës dhe kryerësit në baza etnike, skema / frekuenca krahasuar me incidentet e kaluara, natyra e dhunës, mungesa e motiveve të tjera, lokacioni dhe koha. Më saktë, incidentet e painspektuara ishin refuzuar për shkak të informatave të siguruara në drejtim të lokacionit ku ka ndodhur incidenti (për shembull, lagje dhe shkolla etnikisht të përziera, vende ku krime nga urrejtja kanë ndodhur edhe në të kaluarën etj.), lloji i incidentit (për shembull, një grup më i madh të miturish sulmon një ose më tepër viktimë pa provokime, luftime në grup, sulm mbi autobusët ose stacionet e autobusëve etj.) koha kur ka ndodhur incidenti (pas luftës paraprake si formë e revanshit, pas orëve të mësimi, gjatë garave sportive ose pas përfundimit të tyre etj.) dhe pronë e dëmtuar gjatë incidentit (për shembull tempuj fetar). Rastet e verifikuara dhe të paverifikuara, janë shënuar me ngjyrë të gjelbër, respektivisht me të kuqe, në portalin e Komitetit të Helsinkit - [www.zlostorstvodomraza.mk](http://www.zlostorstvodomraza.mk)

Krahasuar më incidentet e regjistruara gjatë vitit 2013 dhe 2014, dallim më i madh paraqitet te viktimat, shumica e të cilëve janë refugjatë. 21 nga 44 incidente (48%) gjatë vitit 2015 janë për vjedhje ndaj refugjatëve gjatë kohës kur ata kanë kaluar transit nëpër vend. Gjatë këtyre incidenteve, të paktën 58% e viktimave (46% nga numri i përgjithshëm i viktimave të regjistruara) ishin shtetas të Sirisë, Afganistanit dhe Marokut. Dallimi tjetër i madh, por pozitiv është në numrin e incidenteve për shkak të përkatësisë etnike maqedonase ose shqiptare të viktimës, respektivisht kryerësit. Gjatë vitit 2013 këto incidente paraqesin 84% të numrit të përgjithshëm të incidenteve (98 prej 116) ndërsa në vitin 2014 kjo shifër është 61% (53 nga 87). Gjatë vitit 2015 ishin regjistruar vetëm 15 incidente (34%) ndërmjet maqedonasve etnikë dhe shqiptarëve etnikë.

Shumica e veprave nga urrejtja janë kryer nga hajdutë ose të rinj. Veprat penale më të shpeshta janë vjedhje (23), dhunë (21), lëndim trupor (17) dhe shkatërrim i pronës (6). Numri më i madh i incidenteve kanë ndodhur në Shkup (18) dhe rrethinë, ka pasur 10 incidente në Gjevgjeli dhe 6 në Kumanovë. Veprat nga urrejtja kundër refugjatëve zakonisht kanë ndodhur në autostradën e cila është pjesë e Korridorit 10 Panevropian. Ishin regjistruar të paktën 125 viktimë dhe 174 kryerës të veprave të urrejtjes. Shumica e viktimave janë refugjatë dhe të rinj me përkatësi etnike maqedonase ose shqiptare. Në 33 prej 44 incidenteve të kryera, kryerësit kanë vepruar si grup. Nga përgjigjet e marra me shkrim nga MPB-ja, policia i ka zbuluar kryerësit në të paktën 20 incidente. Për 20 incidentet e tjera policia ka qenë e njoftuar dhe ata kanë qenë nën hetim.

## VIII. TË DREJTAT EKONOMIKE DHE SOCIALE

### 1. HYRJA

Gjatë vitit 2015 në Komitetin e Helsinkit është regjistruar numër i madh i parashtresave për shkeljen e të drejtave ekonomike dhe sociale, që para së gjithash janë si pasojë e përqindjes së lartë të papunësisë në vend, varfërimit të popullatës dhe shkeljes së të drejtave të punëtorëve, të drejtave sociale dhe shëndetësore.

Konstatimi i përgjithshëm është se Fondi i Sigurimit Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë dhe Ministria e Shëndetësisë, nuk veprojnë në pajtim me dispozitat ligjore pozitive dhe nuk i respektojnë afatet ligjore për përpilimin e zgjedhjeve, ndërsa veprimi i këtillë në mënyrë të drejtpërdrejtë i cenon të drejtat e qytetarëve që rezultojnë nga Ligji për Mbrojtje Shëndetësore dhe Ligji për Sigurim Shëndetësor.

Qendrat për Punë Sociale si shërbim publik i qytetarëve, në veçanti kur bëhet fjalë për lehtësimin e qasjes te realizimi i të drejtave sociale të qytetarëve të cilët janë në rrezik social, dështojnë gjatë punës së tyre. Shfrytëzuesit e të drejtave të mbrojtjes sociale shpesh përballen me zgjidhje me të cilat u ndërpriten të drejta të caktuara, pikërisht për shkak të mosinformimit të përgjithshëm rreth paraqitjes së ndryshimeve financiare të llogarive të tyre transaksionale dhe në mënyrë konsekuente, për shkak të mosfunksionimit të shërbimeve profesionale të qendrave për punë sociale. Si rrjedhojë, shumë shpesh ndodh të ndërpritet e drejta për asistencë sociale me të holla, pa marrë parasysh shumën e pakonsiderueshme të paraqitur në lidhje me mirëqenien e qytetarëve. Edhe përkrah ngritjes së procedurave ankimore, por edhe procedurave në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë nga fusha e mbrojtjes sociale, për shkak të procedurave tepër të gjata dhe punës joefektive, qytetarët edhe më tej janë penguar të realizojnë të drejtat e tyre ekonomike dhe sociale.

### 2. FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR NUK I MBRON TË DREJTAT E PERSONAVE TË SIGURUAR

Te Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë, u paraqit parashtresë nga personi Zhaklina Dimovska, me të cilën ajo informoi në lidhje me pamundësinë të realizojë të drejtat e saj të përcaktuara me Ligjin për Sigurim Shëndetësor. Respektivisht, Zhaklina Dimovska, si person i siguruar, ka paraqitur kërkesë për dërgim për shërim jashtë shtetit, për fëmijën e saj të mitur Tamara Dimovska, duke paraqitur si shtojcë dokumentacionin mjekësor. Mirëpo, nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor është refuzuar si e pabazuar edhe përkrah faktit se ish-in siguruar të gjitha informacionet nga të gjitha institucionet mjekësore të cilat kanë konfirmuar se nuk posedojnë me pajisjen e nevojshme teknike dhe mjekësore për kryerjen e intervenimit kirurgjik. Megjithatë, organi i shkallës së parë ka konstatuar se nuk janë shfrytëzuar ende të gjitha mundësitë për shërim në vend si arsyetim për vendim e tyre negativ.

Duke marrë parasysh mendimin konsultativ të ekipit të mjekëve të dhënë me propozimin për dërgim për shërim jashtë shtetit si dhe urgjenca për kryerjen e intervenimit, Komiteti i Helsinkit, konstatoi se organi i shkallës së parë nuk e ka respektuar dhe nuk e ka zbatuar nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit për Sigurim Shëndetësor, respektivisht personi i siguruar mund të fitojë shërbim spitalor jashtë shtetit me leje nga Fondi, nëse bëhet fjalë për sëmundje e cila nuk mund të shërohet në vend.

Për shkak të pakujdesisë dhe joligjshmërisë në veprimin e institucioneve kompetente gjatë procedimit ky rast përfundoi me epilog tragjik, respektivisht personi i siguruar i mitur, Tamara Dimovska ndërroi jetë më 09.02.2015. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, përpiloi dhe paraqiti padi penale kundër drejtorëve, kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Këshillit Drejtues të Fondit dhe kundër anëtarëve të komisionit mjekësor të shkallës së parë dhe shkallës së dytë, për shkak të dyshimit të bazuar për punë të pandërgjegjshme të shërbimit, si dhe kundër ministrit të Shëndetësisë Nikolla Todorov, për keqpërdorimin e pozitës dhe autorizimit zyrtar. Deri në përfundim të këtij raporti, Prokuroria Publike Themelore, ende nuk kishte ngritur akuza kundër të paraqiturve.

Si rezultat i mbulimit të madh nga mediat i këtij rasti, te Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë u drejtuan qytetarë që kanë problem të njëjtë me institucionet, Fondin e Sigurimit Shëndetësor dhe Ministrinë e Shëndetësisë të Republikës së Maqedonisë. Respektivisht, nga dokumentacioni që e paraqitën te Komiteti i Helsinkit, ekipi juridik i Komitetit konstatoi se bëhet fjalë për persona të siguruar të mitur, të cilëve u nevojitet intervenim kirurgjik që duhet të kryhet jashtë shtetit, sepse për këtë nuk ka mundësi, as kushte të kryhet në Republikën e Maqedonisë. Vendimet e marra nga Komisionet e mjekëve të Fondit për Sigurim Shëndetësor, janë në kundërshtim me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit për Sigurim Shëndetësor, me të cilin rregullohet shërimi spitalor i të siguruarve jashtë shtetit.

Pas inspektimit të kryer mbi të gjithë dokumentacionin e dorëzuar, ekipi juridik i Komitetit, doli me përfundim se vendimet e shkallës së parë dhe të dytë të Fondit të Sigurimit Shëndetësor, janë identike për të gjithë personat e siguruar, respektivisht të gjithëve u është refuzuar kërkesa për shërim jashtë shtetit, gjatë kësaj pa u shqyrtuar dokumentacioni i dorëzuar dhe pa u respektuar udhëzimet dhe sugjerimet e mendimit konsultativ i personave profesionist mjekësor dhe me këtë drejtpërdrejtë u shkurtohen të drejtat nga neni 30 paragrafi 1 të Ligjit për Sigurim Shëndetësor. Disa prej personave që iu drejtuan Komitetit, kanë paraqitur padi kundër vendimeve të shkallës së dytë edhe te Gjykata Administrative e Republikës së Maqedonisë, mirëpo edhe këtu janë përballur me probleme institucionale, sepse Gjykata Administrative nuk ka vendosur në mënyrë meritore dhe rastet i ka kthyer përsëri për vendimmarrje me ç'rast procedurat janë zgjatur dhe është pamundësuar realizimi i të drejtave të tyre.

Me veprimin e tillë, respektivisht, mosveprimin e Gjykatës Administrative, personat e siguruar humbin kohën e tyre të çmuar nëpër labirintet juridike, ndërsa ndërkohë përballen me përkeqësim dhe komplikimin e gjendjes shëndetësore. Për shkak të seriozitetit dhe vëllimit të problemit, Komiteti i Helsinkit i Republikës së Maqedonisë sugjeron q; institucionet kompetente, Fondi i Sigurimit Shëndetësor dhe Ministria e Shëndetësisë duhet të veprojnë në pajtim me dispozitat ligjore pozitive dhe të respektojnë afatin e përcaktuar, me qëllim në të ardhmen, qytetarët të mos kenë probleme gjatë realizimit të të drejtave nga sigurimi shëndetësor.

### 3. ZBATIMI RETROAKTIV I RREGULLORES, NË DËM TË QYTETARËVE

Gjatë muajit shkurt te Komiteti i Helsinkit arritën parashtrësia në lidhje me ndërprerjen e pabazuar të asistencës sociale me para, sepse qytetarët kanë pranuar të holla nëpërmjet transferimit të shpejtë të parave.

Duke i analizuar parashtrirat e arritura dhe vendimet për anulimin e asistencës sociale të cilat janë dërguar si shtesë, ekipi juridik i Komitetit të Helsinkit konstatoi se Qendrat Sociale për asistencë me para në këto vendime i referohen nenit 4 paragrafi 1 pika 7 të “Rregullores për mënyrën e përcaktimit të gjendjes së të ardhurave, pronës dhe së të drejtave pronësore të ekonomisë familjare, përcaktimin e bartësit të të drejtës dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin dhe shfrytëzimin e të drejtës për ndihmë me para”, i cili është miratuar më datë 02.01.2015 ndërsa ka hyrë në fuqi pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë. Me këto ndryshime të rregullores përcaktohet se mjetet financiare të pranuar nëpërmjet transferimit të shpejtë të parave në shumë mbi 50.000 denarë, do të konsiderohen si të ardhura.

Duke pasur parasysh se ndryshimet në këtë nen kanë hyrë në fuqi pas miratimit të aktvendimeve nga Qendrat me të cilat shfrytëzuesve nuk u është ndërprerë asistencë sociale me para, Komiteti i Helsinkit konstatoi se bëhet fjalë për zbatim retroaktiv të dispozitave ligjore që është në kundërshtim me nenin 52 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë. Respektivisht, me nenin 52 të Kushtetutës, është përcaktuar se ligjet dhe dispozitat nuk mund të kenë veprim retroaktiv, përveç me përjashtim, kur kjo është e dobishme për qytetarët, por që nuk paraqet shembull për rastin konkret. Përkundrazi, për shkak të zbatimit retroaktiv të rregullores cenohet statusi social edhe ashtu i keq i këtyre qytetarëve.

Për shkak të kësaj që u tha më lart, Komiteti siguroi ndihmë juridike për më tepër se 10 raste dhe njëkohësisht paraqiti mendim të Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, për zbatimin jopërkatës të dispozitave ligjore të Rregullores, duke sugjeruar ndalimin e zbatimit retroaktiv të rregullave, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Duke parë problemet të cilat rezultojnë nga zbatimi joligjor i kësaj Rregullore, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale më 25 janar 2016 e ndryshoi Rregulloren në mënyrë që e hoqi dispozitën kontestuese me qëllim të mbrohen shfrytëzuesit nga heqja e të drejtës që e kanë fituar për pranimin e mjeteve financiare nëpërmjet transferimit të shpejtë të parave në lartësi deri në 70,000 denarë. Me këtë ndryshim, përmirësohet mundësia e shfrytëzuesve të asistencës sociale me para për pranimin e mjeteve financiare nëpërmjet transferimit të shpejtë të parave, të cilat do të mund t’i shfrytëzojnë për nevojat e tyre dhe gjendjen e tyre sociale dhe shëndetësore (shërim të gjatë, blerje të pajisjeve ortopedike) gjatë kësaj pa i llogaritur të njëjtat si pronë prej të cilës jetojnë. Gjithashtu, duam të dërgojnë mesazh të Ministria e Punës dhe Politikës Sociale që në të ardhmen planet strategjike të synojnë rritjen e lartësisë së mjeteve financiare me qëllim shfrytëzuesit të kenë mundësi t’i mbulojnë shpenzimet e tyre mujore dhe t’i kënaqin nevojat e tyre themelore.



## IX. DHUNË NË BAZË TË GJINISË

### 1. HYRJA

Gjatë vitit 2015 Komiteti i Helsinkit regjistroi edhe 5 raste të reja të femicid – respektivisht vrasje të grave nga partnerët martesorë aktualë ose të mëparshëm ose nga partnerët intimë. Një prej vrasjeve më brutale ka ndodhur gjatë muajit tetor 2015 kur burri e vrau gruan me sëpatë. Në buletin e ngjarjeve ditore, Ministria e Punëve të Brendshme si shkak për vrasjen i theksoi marrëdhëniet e çrregulluara familjare, ndërsa jozyrtarisht, ngjarjes i ka paraprirë grindje. Vetëm dy ditë më pas, në media u bë publike ngjarja në Koçan, ku një burë i ka dhënë fund jetës duke u varur, mbasi një natë më parë fizikisht e ka keqtrajtuar bashkëshorten dhe e ka shpuar me thikë në dorë.

Komiteti i Helsinkit rikujton me shqetësim se këto dy ngjarje janë vetëm vazhdim i ngjarjeve të shumta të dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje të cilat kanë përfunduar me vdekje gjatë dy viteve të fundit. Respektivisht, gjatë muajit maj, një grua më e moshuar u gjet e vdekur në shtëpinë e saj në lagjen e Shkupit Përzhino, me shenja të dukshme të dhunës, për çka i dyshuari i parë është djali i saj. Në janar, një grua shtatzënë u vra në Klinikën e Fëmijëve në Shkup dhe më pas u hodh nga çatia nga person i panjohur. Gjatë vitit 2014, organet shtetërore për zbatimin e ligjit dështuan në parandalimin e 5 rasteve të dhunës në baza gjinore, që përfunduan me vdekje. Gjatë fillimit të muajit maj, 2014, u gjet trupi i pajetë i një gruaje nga Kavadari, për vdekjen e së cilës u akuzua bashkëshorti i saj. Nga fundi i muajit, një burrë nga Shkupi me armë zjarri e ka vrarë partneren e tij me të cilën ka qenë në lidhje dashurie dhe më pas ka vrarë veten. Viktima kohë më të gjatë është ankuar se po i kërcënohet se nëse largohet nga ai do ta vrasë. Nga fundi i muajit korrik, një mashkull nga Shkupi, me armë zjarri e ka vrarë partneren dhe motrën e saj, pas kësaj është vetëvrasë. Vetëm pas tre muajsh, në nëntor, vijoi vrasje e trefishtë në Kavadar, ku burri vrau nënën, babanë dhe motrën e bashkëshortes me të cilën kanë qenë në fazë të divorcit. Kryerësin disa herë e kanë paraqitur për dhunë familjare, por institucionet nuk kanë siguruar mbrojtje për viktimat. Nga fundi i muajit nëntor, përsëri u krye vrasje e trefishtë, në Zletovë, ku burri vrau prindërit e bashkëshortes me të cilën po ndahej, dhe të njohurin e tyre, xhaxhain e djalit me të cilin kryerësi ka dyshuar se është në lidhje ish-bashkëshortja e tij. Kryerësin disa herë e kanë paraqitur tek organet kompetente për dhunë familjare.

Gjatë periudhës së raportit Komiteti i Helsinkit, siguroi ndihmë juridike në 10 raste të dhunës në baza gjinore, duke përfshirë edhe rastin e përndjekjes së vajzës nga ish-partneri i saj intim. Gjendja e tillë shqetëson në veçanti nëse merret parasysh se shteti nuk siguron mbrojtje për të gjitha format e dhunës në baza gjinore, as nuk mban evidencë të veçantë për rastet e femicidit. Prandaj, mund të konstatohet se shteti ende nuk i plotëson standardet minimale të cilat duhet të garantojnë mbrojtjen efikase nga dhuna mbi gratë. Mungesa e reagimit përkatës nga policia dhe qendrat për punë sociale, numri i vogël i qendrave shelter për strehim të viktimave të dhunës familjare, mungesa e qendrave shelter për strehim të viktimave të dhunës seksuale janë

vetëm një pjesë e problemeve sistemore, për shkak të të cilave mund të konstatohet se shteti nuk i plotëson kushtet për sigurimin e mbrojtjes së drejtë për gratë viktime të dhunës në baza gjinore. Këto kushte janë përcaktuar me Konventën e Stambollit, e cila përfaqëson dokumentin e parë ndërkombëtar për mbrojtjen e grave nga dhuna, të cilën Republika e Maqedonisë e ka nënshkruar, por ende nuk e ka ratifikuar.

Në rast të ratifikimit të kësaj konvente shteti do të duhet të sinkronizojë legjislationin vendas me standardet ndërkombëtare, do të ketë obligim të realizojë më tepër fushata ose programe për ngritjen e vetëdijes, do të përmirësohen intervenimet parandaluese të shtetit dhe programet për trajtimin e viktimave dhe kryerësve, do të duhet të hapen më tepër qendra shelter strehimi të cilat do të jenë funksionale, do të vendosen rrethana të vështirësuar për kryerësit e veprave penale të përcaktuara me Konventën, masat për mbrojtjen e viktimave do të duhet të jenë funksionale dhe të zbatueshme në praktikë. Për këto arsye shteti duhet sa më parë të fillojë procesin e ratifikimit të Konventës së Stambollit dhe të sigurojë standarde minimale për mbrojtje efikase të grave viktime të dhunës.

## 2. VRASJA E TREFISHTË NË KAVADAR

Nga fundi i vitit 2014 publiku u informua mbi vrasjen e shumëfishtë në Kavadar të anëtarëve të familjes të gruas - viktime të dhunës familjare, e kryer me përdorimin e armës të zjarrtë nga ish-bashkëshorti i saj. Edhe në këtë rast institucionet kompetente nuk i mundësuan mbrojtje nga dhuna viktimës të cilën ajo dhe familja e saj e kanë duruar kohë më të gjatë që ushtrohej nga ish-bashkëshorti i saj.

Për shkak të punës joefikase dhe të pandërgjegjshme të institucioneve në rastin konkret, prokuroria publike ngriti hetim kundër nëpunësve policorë dhe të punësuarve në Qendrën për Punë Sociale, të cilët kanë vepruar në këtë rast.

Nëpunësit policorë dhe të punësuarit në Qendrën për Punë Sociale Kavadar janë dënuar për punë të pandërgjegjshme në shërbim sepse nuk kanë ndërmarrë veprime për mbrojtjen e viktimës. Gjatë procedurës kundër nëpunësve policorë viktime nuk është thirrur të marrë pjesë edhe pse është dëmtuar nga punë e tyre e pandërgjegjshme. Për shkak të kufizimit të të drejtës të marrë pjesë gjatë procedurës si viktime, respektivisht e dëmtuar, si edhe për faktin që nëpunësit policorë duhej të ndiqen për vepra të rënda penale, Komiteti i Helsinkit i siguroi ndihmë juridike viktimës, për paraqitjen e Kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e cila iu depozitua Prokurorit publik të RM-së. Në përgjigjen e tij Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë e njoftoi viktimën se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar, duke pasur parasysh atë se nuk është shkëlur ligji ose marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Veprimi i këtillë nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë, respektivisht fakti se viktime nuk është e përfshirë në procesin gjyqësor kundër nëpunësve policorë në lidhje me mosveprimin e tyre në lidhje me kërkesën e viktimës për konfiskimin e armës, paraqet shkelje të rëndë të të drejtave të viktimës, me çka vërtetohet mbrojtja joefikase e cila ekziston ndaj femrave viktime të dhunës familjare.

Komiteti i Helsinkit konsideron se përfshirja e viktimave së dhunës familjare në proceset gjyqësore kundër nëpunësve policorë të cilët nuk kanë vepruar në pajtim me ligjin është e nevojshme nëse dëshirojmë të flasim për mbrojtje efikase të viktimave të dhunës familjare. Për këto arsye rekomandojmë që në të ardhmen prokuroria publike të marrë parasysh në veçanti faktin se viktimat dëmtohen edhe nga puna e pandërgjegjshme e personave të autorizuar për sigurimin e mbrojtjes në rastet e dhunës familjare.

### 3. SHQETËSIMI DHE CENIMI I SIGURISË NGA ISH-PARTNERI INTIM

Nga fundi i vitit 2015 personi X kërkoi ndihmë juridike nga Komiteti i Helsinkit, si viktimë e shqetësimit dhe cenimit të sigurisë nga ish-partneri intim. Respektivisht, ish-partneri i saj, duke përdorur armë, thikë, i është kërcënuar seriozisht se do të sulmojë jetën dhe trupin e saj dhe jetën dhe trupin e personit të saj të afërm. Viktima ka thërritur policinë e cila ka përpiluar shënim zyrtar, procesverbal dhe ka marrë deklaratë nga e dëmtuara dhe nga dëshmitari okular. Pas kalimit të më tepër se 45 ditë nga paraqitja e ngjarjes në fjalë, e dëmtuara ka shkuar në SPB - Shkup - Qendër të informohet në lidhje me rastin, ku është informuar me gojë se rasti është mbyllur si ankesë, ndërsa i dyshuari është thirrur në polici dhe i është tërhequr vërejtja.

Organet policore kanë pasur informata se i dyshuari edhe më parë ka pasur kallëzime nga e dëmtuara për ngjarje të ngjashme, i njëjti edhe më parë është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm, si dhe faktin se i dyshuari u ka bërë kërcënime për jetën dhe trupin të dëmtuarës dhe partnerit të saj aktual, për çka ekzistojnë mesazhe SMS të shkruara dhe kallëzime në polici për ngjarjet në fjalë.

Organet policore kanë pasur informata se i dyshuari edhe më parë ka pasur kallëzime nga e dëmtuara për ngjarje të ngjashme, i njëjti edhe më parë është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm, si dhe faktin se i dyshuari u ka bërë kërcënime për jetën dhe trupin të dëmtuarës dhe partnerit të saj aktual, për çka ekzistojnë mesazhe SMS të shkruara dhe kallëzime në polici për ngjarjet në fjalë.

Për shkak të mosveprimit të nëpunësve policorë, e dëmtuara ka paraqitur kallëzim penal te PPTH - Shkup për rastin konkret, e cila ka ngritur akuzë për kryerjen e veprës penale nga neni 133 i KP - Cenim me armë të rrezikshme gjatë rrahjes ose grindjes. Pas mbajtjes të seancës publike, kryesore dhe me gojë, Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup, mori vendim me të cilin të akuzuarin e shpalli fajtor për veprën penale të lartpërmendur dhe e dënoi me dënim me burg prej 4 muajsh.

Edhe pse, kryerësi është dënuar tashmë, ai vazhdon ta shqetësojë dhe ta kërcënojë të dëmtuarën dhe me sjelljen e këtillë ai e rrezikon vazhdimisht sigurinë dhe e shqetëson të dëmtuarën dhe familjen e saj.

## X. KRIZA E REFUGJATËVE

Nga fundi i vitit 2014 dhe nga fillimi i vitit 2015, Maqedonia dëshmoi një fluks të paparë të refugjatëve që kalojnë transit nëpër territorin e shtetit drejt shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Që nga fillimi i regjistrimit nga ana e shtetit në qershor 2015 deri në fund të vitit, u regjistruan rreth 390,000 refugjatë nga të cilët rreth 210,000 të gjinisë mashkullore, 95.000 fëmijë dhe 65.000 të gjinisë femërore. Pjesa më e madhe e refugjatëve ishin shtetas të Sirisë, Afganistanit dhe Irakut. Duke pasur parasysh se regjistrimi filloi në qershor 2015 dhe, se disa muaj mëshoheshin një numër i madh i refugjatëve të paregjistruar, numri real për vitin 2015 është shumë më i lartë sesa ai i regjistruar. Refugjatët nuk pranorin të qëndrojnë në Maqedoni të kërkojnë azil, kështu që nga të gjithë refugjatët e regjistruar vetëm 86 aplikuan për azil. Numri më i madh i azilkërkuessve mbetën në vend vetëm për një kohë të shkurtër, më pas e vazhdonin rrugën drejt Bashkimit Evropian edhe atë para se të fillonte procedura për azil. Për fat të keq, shteti e nënçmoi krizën e refugjatëve dhe përgatitjet për pranin i filluan tepër vonë që rezultoi me një numër të madh të shkeljeve të të drejtave të refugjatëve.

### *a) Viktima përgjatë shinave*

Duke i konsideruar ata si “emigrantë të paligjshëm” Maqedonia nuk lejoi përdorimin e transportit publik dhe i detyroi refugjatët të ecin përgjatë gjithë vendit në përpjekje për të arritur në Serbi. Në rrugën e tyre, ata shpesh e përdornin hekurudhën nga Gjevgjelia në Tabanovc. Më 24 prill 2015, në afërsi të Velesit treni u mori jetën 14 emigrantëve nga të cilët të paktën gjashtë persona ishin të mitur. Në periudhën prej vitit 2014 deri në fund të majit 2015 u vranë të paktën 29 refugjatë, duke përfshirë edhe foshnja, fëmijë dhe gra. Neni 29 i Kushtetutës përcakton që të huajt gëzojnë liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë, sipas kushteve të përcaktuara me ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Maqedonia si nënshkruese e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duhej t'i ndërmarrë hapat e duhura nëpërmjet të cilave do t'i mbronte jetët e atyre që kalonin transit nëpër territorin e saj. Për fat të keq, edhe pse Ministria e Punëve të Brendshme ishte e vetëdijshme për rreziqet të cilave u ishin nënshtruar refugjatët, shteti mori masa shumë pak të përshtatshme për t'i mbrojtur të drejtat e tyre njerëzore më themelore.

### *b) Qendra për strehim të të huajve – Gazi Babë*

Deri në qershor të vitit 2015, shteti mbante refugjatë dëshmitarë dhe viktime të trafikimit të qenieve njerëzore në qendrën e vetme të strehimit për të huajt në Gazi Babë. Disa nga këta njerëz ishin nën kontroll

sigurie të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim. Procedura e arrestimit kryhej në mënyrë të paligjshme. Sipas nenit 108, paragrafi 3 të Ligjit për të Huajt, Ministria e Punëve të Brendshme ka miratuar vendim për mbajtjen e përkohshme për të huajt, dhe në paragrafin 5 përcakton se i huaji ka të drejtë të ankohet para Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative të shkallës së dytë dhe pastaj te Gjykata Administrative dhe te Gjykata e Lartë Administrative. Sipas nenit 19, paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën Administrative, pjesëmarrësit në procedurë të cilët nuk janë shtetas të R.M-së dhe që nuk e kuptojnë gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik kanë të drejtë për përkthyes. Me nenin 61, paragrafi 5 është paraparë që organet para të cilave zhvillohet procedura administrative të përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën zyrtare të cilën e përdor pala. Paligjshmëria e procedurave të paraburgimit konsistonte në mossigurimin e përkthyesve nga Ministria e Punëve të Brendshme kështu që emigrantët, refugjatët nuk ishin në gjendje as të kuptojnë e as të apelojnë për paraburgimin e tyre. Qendra strehimore në Gazi Babë në gjysmën e parë të vitit 2015 ishte e mbipopulluar, në shkatërrim dhe ishte e mbyllur për shoqatat civile dhe mediat. Pas reagimit të organeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara, Avokatit të Popullit, OJQ-ve dhe aktivistëve, gjatë verës së vitit 2015 të gjithë refugjatët e ndaluar u liruan, por prokurorët publikë e vazhduan praktikën e dërgimit të dëshmitarëve në Qendër, edhe pse në numër shumë më të vogël.

### *c) Shprehja e qëllimit për azil*

Gjatë muajit qershor, Kuvendi i RM-së miratoi ndryshimet në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Azil dhe Mbrojtje të Përkohshme. Zgjidhja e propozuar u mundësoi refugjatëve që të shprehin dëshirën për dorëzimin e kërkesës për njohjen e të drejtës për azil para një nëpunësi të policisë. Pastaj ata patën mundësi, brenda 72 orëve ta paraqesin kërkesën e tillë. Në periudhën e shprehjes së dëshirës për dorëzimin e kërkesës, nuk konsiderohen emigrantët ilegalë, kështu që përkohësisht u lejohet lëvizje e lirë dhe përdorimi i ligjshëm i mjeteve për transport publik. Kjo zgjidhje e uli numrin e kontrabandistëve që më parë përbënin një problem të madh.

### *ç) Gjendja e krizës*

Më 19 gusht 2015, Qeveria e Republikës së Maqedonisë miratoi vendim për shpalljen e gjendjes së krizës në kufijtë jugorë dhe veriorë të vendit, kjo në lidhje me valën e refugjatëve në vend. Me vendimin e Parlamentit të RM-së, gjendja e krizës u zgjat deri në qershor 2016. Pas shpalljes së gjendjes së krizës nga Qeveria, nga materialet e publikuara nga mediat,<sup>23</sup> dhe vëzhgimi i drejtpërdrejtë i përfaqësuesve të Komitetit të Helsinkit të cilët ishin të pranishëm në kufirin jugor, mund të shihej trajtimi çnjerëzor i refugjatëve nga ana e zyrtarëve të policisë speciale të cilët përdorën masa të dhunshme, duke përdorur gaz lotsjellës dhe shok-bomba në përpjekjen e pasuksesshme për t'i parandaluar refugjatët ta kalojnë territorin.

### *d) Mbrojtja mjekësore*

Në përgjithësi, mbrojtjen shëndetësore e siguronte Kryqi i Kuq, dhe një numër i vogël i refugjatëve morën trajtim mjekësor në disa objekte shëndetësore publike, vetëm në raste urgjente dhe raste të rënda. Gjatë muajit gusht, 23 nga 25 klinika private të komunave të Gjevgjeliës, Vallandovës, Dojranit dhe Bogdancit nëpërmjet një peticioni të nënshkruar nga mjekët e informuan Fondin për Sigurim Shëndetësor (FSSH) se nuk do t'i binden

<sup>23</sup> <http://www.makdenes.org/media/video/27200964.html>

urdhrit për kujdestari në klinikën për emigrantët që ndodhej në stacionin policor në Gjevgjeli. Nëpërmjet peticionit mjekët thanë se nuk do ta pranojnë detyrën në ambulanca, sepse ata nuk kishin detyrim të tillë ligjor ose me marrëveshje. Sipas tyre, e ashtu quajtura ambulantë e përshtatur nuk kishte as kushte themelore për sigurimin e kujdesit shëndetësor, pajisje mjekësore, materiale mjekësore, materiale sanitare që shpenzohen. Ky refuzim nuk ishte në pajtim me Betimin e Hipokratit, të vendosur si betim të mjekëve e përfshirë në Deklaratën e Gjenevës në vitin 1948. Sipas këtyre betimeve, mjekët vënë jetën e tyre në shërbim të njerëzimit dhe profesionin duhet ta kryejnë me ndërgjegje dhe me dinjitet. Në kryerjen e detyrës ndaj pacientëve, mjekët nuk duhet të kenë asnjëfarë paragjykim sa i përket moshës, sëmundjes apo aftësive të kufizuara, përkatësisë etnike, gjinisë, fesë, kombësisë apo racës.

### *dh) Kontrabandë dhe grabitje*

Një numër i madh i refugjatëve që kanë hyrë në vend në mënyrë të paligjshme u bënë viktima të kontrabandistëve dhe akteve të urrejtjes. Mediat raportonin në baza javore për numër të madh incidentesh që kishin të bëjnë me kontrabandë, ndërsa Komiteti i Helsinkit regjistroi 21 incidente grabitjesh. Gjatë këtyre incidenteve, të paktën 58 viktima ishin shtetas të Sirisë, Afganistanit dhe Marokut. Sulmet grabitëse ‘kanë karakteristika të ngjashme, domethënë viktimize ose u ofrohet transport i rrejtshëm ose kapen nga ndjekësit me kërcënim serioz apo mashtrim se janë policë, me armë të ftohta (nganjëherë armë të zjarrit dhe shkopinj elektrik) i frikësojnë, sulmojnë, lëndojnë dhe i plaçkitin. Më shumë detaje rreth çdo sulmi individualisht, si dhe për sulme të tjera të regjistruara mund të gjeni në portalin për regjistrimin e akteve të urrejtjes të Komitetit të Helsinkit - [www.zlostorstvaodomraza.mk](http://www.zlostorstvaodomraza.mk).

### *e) Kampet transite*

Për shkak të pritjes dhe transportit kaotike të refugjatëve, banorët e Gjevgjelisë protestuan për shkak të numrit të madh të refugjatëve në qytetin e tyre. Në shtator 2015 transiti i refugjatëve filloi të zhvillohet në mënyrë të organizuar nëpërmjet kampeve të improvizuara tranzitore në jug afër Gjevgjelisë (Vinojug) dhe në veri pranë Kumanovës (Tabanovc). Kampet u ngritën larg zonave të populluara, përgjatë hekurudhës 500 metra nga kufiri me Greqinë, gjegjësisht me Serbinë. Kampet zgjeroheshin çdo ditë, ndërsa transiti kryhej në mënyrë të organizuar me regjistrimin e refugjatëve në Gjevgjeli dhe me transport të drejtpërdrejtë në linjë emergjente të trenave të Hekurudhave të Maqedonisë.

### *ë) Diskriminimi gjatë përdorimit të transportit hekurudhor*

NP Hekurudhat e Maqedonisë ShA Transport për një periudhë të shkurtër kohore dy herë bëri korigjim të kostos të biletës për refugjatët që kalojnë transit nëpër Maqedoni. Çmimi i çdo bilete të vetme për këta përdorues është 25 euro dhe është për 3.5 herë më i lartë se çmimi i rregullt i biletës që kushton rreth 7 euro. Uljet e rregullta për fëmijët, familjet dhe grupet nuk zbatohen. Me ngritjen e çmimit të biletave të refugjatëve, NP Hekurudhat e Maqedonisë prezantoi praktikën e trajtimit të pabarabartë të refugjatëve dhe shkeli të drejtat e përfshira në nenin 29 paragrafi 1 të Kushtetutës, i cili thotë: “Të huajt në Republikën e Maqedonisë gëzojnë liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë, në bazë të kushteve të përcaktuara me ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare.” Sipas shpjegimit të NP Hekurudhat e Maqedonisë, çmimi më i lartë ishte për shkak të shërbimeve të veçanta dhe angazhimit të mjeveve dhe stafit shtesë për ta siguruar transportin.

*f) Profilizimi racor*

Gjatë muajit nëntor të vitit 2015 filloi zgjedhja diskriminuese për pranimin e refugjatëve në bazë të vendit të tyre të origjinës nga ana e Sllovenisë. Kjo praktikë reflektoi si një reaksion zinxhir në të gjitha pikat kufitare të itinerarit ballkanik. Si pasojë, në të gjithë Republikën e Maqedonisë lëshoheshin vetëm refugjatë që vijnë nga Siria, Afganistani dhe Iraku ndërsa refugjatët me dokumente të origjinës nga vende të tjera nuk u lëshuan. Kjo situatë ka shkaktuar kalimin e paligjshëm të kufirit shtetëror nga të gjithë refugjatët të cilët nuk janë shtetas të një prej vendeve të përmendura. Për t'i parandaluar kalimet e paligjshme, shteti ndërtoi një gardh me tela me gjemba në kufirin me Greqinë.

